




TË DIPLOMUARIT NGA
ARSIMI PROFESIONAL **2024**
GJURMIMI NË NIVEL KOMBËTAR

Një projekt i Agjencisë Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

Në partneritet me:



Zbatuar nga:





TË DIPLOMUARIT NGA
ARSIMI PROFESIONAL **2024**

GJURMIMI NË NIVEL KOMBËTAR



TË DIPLOMUARIT NGA ARSIMI PROFESIONAL 2024: GJURMIMI NË NIVEL KOMBËTAR

Ky publikim është realizuar në bashkëpunim midis Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA) dhe projektit “Aftësi për Punë” (S4J).

Raporti u përgatit nga Blerina Metanj PhD, konsulente dhe Assoc. Prof. Ines Nurja, konsulente për metodologjinë, nën mbikëqyrjen e Menaxheres për Qëndrueshmërinë të Projektit, Aleka Papa.

Rreth projektit “Aftësi për Punë”

“Aftësi për Punë” (S4J), është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), i cili zbatohet në Shqipëri nga organizata Swisscontact.

Shënim: Pikëpamjet dhe konkluzionet e shprehura në këtë publikim, nuk paraqesin domosdoshmërisht ato të Qeverisë Zvicerane ose Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

TABELA E PËRMBAJTJES

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	6
1. HYRJJE	9
2. METODOLOGJIA	11
2.1 Qasja metodologjike	11
2.2 Instrumenti i studimit - pyetësoni	11
2.3 Analizimi i të dhënave	13
2.4 Kufizimet metodologjike	13
3. PËRSHKRIMI I DEMOGRAFISË	14
4. SITUATA E PUNËSIMIT E TË DIPLOMUARVE	17
4.1 Situata aktuale e punësimit	17
4.2 Analiza e statusit të punësimit sipas drejtimeve dhe shkollave	19
4.3 Grupet vulnerabël	20
5. TË DIPLOMUARIT E PUNËSUAR	22
5.1 Tranzicioni drejt tregut të punës – koha e gjetjes së punës së parë për të punësuarit	22
5.2 Mënyra e gjetjes së punës së parë	24
5.3 Karakteristikat kryesore në punën aktuale	26
5.4 Integrimi në tregun e punës – Të ardhurat	29
5.5 Përputhja e arsimit me punën aktuale	31
6. TË DIPLOMUARIT QË PO VAZHDOJNË KUALIFIKIME TË MËTEJSHME	37
7. TË DIPLOMUARIT TË CILËT NUK PUNOJNË	40
7.1 Të kërkuarit për punë	40
7.2 Marrëdhënia me zynat e punës	44
8. VLERËSIMI RETROSPEKTIV I TË DIPLOMUARVE	46
8.1 Pritshmëritë për të ardhmen	49
9. KONKLUZIONE	52
ANEKS	54

Lista e tabelave

Tabela 1. Shpërndarja sipas gjinisë për totalin e të diplomuarve dhe të anketuarve, 2024	14
Tabela 2. Shpërndarja sipas drejtimeve mësimore për të diplomuarit dhe të anketuarit, 2024	14
Tabela 3. Shpërndarja sipas rajoneve e të anketuarve, 2024	15
Tabela 4. Të diplomuar dhe të anketuar sipas përkatësisë etnike, aftësisë së kufizuar dhe nëse janë nga familje me ndihmë ekonomike, 2024	16
Tabela 6. Statusi i punësimit sipas rajoneve, 2024	18
Tabela 7. Statusi i punësimit sipas drejtimeve, 2024	19
Tabela 8. Statusi i punësimit sipas grupeve vulnerabël sipas viteve	21
Tabela 9. Kur e ke filluar punën tënde të parë pas mbarimit të shkollës sipas viteve të diplomimit	23
Tabela 10. Puna e parë pas mbarimit të shkollës sipas drejtimit, 2024	24
Tabela 11. Mënyra e gjetjes së punës sipas viteve të diplomimit	25
Tabela 12. Mënyra e gjetjes së punës sipas rajoneve, 2024	26
Tabela 13. Numri i punonjësve në kompaninë ku të diplomuarit punojnë sipas viteve të diplomimit	26
Tabela 14. Lloji i kontratës së punës sipas viteve të diplomimit	27
Tabela 15. Perceptimi i sigurisë në punën aktuale sipas viteve të diplomimit	27
Tabela 16. Perceptimi i sigurisë në punën aktuale sipas drejtimeve	28
Tabela 17. Të ardhurat sipas drejtimit, 2024	30
Tabela 18. Lidhja e ansimit me punën aktuale sipas kategorive të punësimit, 2024	32
Tabela 19. Përdorimi i njohurive të marra gjatë studimeve në punën aktuale sipas viteve të diplomimit	33
Tabela 20. Lidhja e punës dhe studimet, si dhe aplikimi i njohurive të marra në shkollë në punë, 2024	34
Tabela 21. Koha pas diplomimit për hapjen e biznesit sipas viteve	35
Tabela 22. Perspektiva e vetë-punësimit sipas viteve të diplomimit	36
Tabela 23. Lidhja e fushës së studimeve me studimet e mëparshme sipas drejtimit 2024	38
Tabela 24. Arsyeja kryesore pse po ndjek këto studime/trajnim sipas viteve të diplomimit	39
Tabela 25. Mënyra e kërkimit të punës (ata që kanë kërkuar punë 4 javët e fundit) sipas viteve të diplomimit	42
Tabela 26. Mënyra e kërkimit të punës sipas rajoneve, 2024	42
Tabela 27. Ansyet e mos kërkimit të një pune (ata që nuk kanë kërkuar punë) sipas viteve të diplomimit	43
Tabela 28. Regjistruar si punëkërkues i papunë tek zyra e punës sipas viteve të diplomimit	44
Tabela 29. Ansyet e mos regjistrimit në zyrat e punës sipas viteve të diplomimit	44
Tabela 30. Ansyet e mos regjistrimit në zyrat e punës sipas rajoneve, 2024	45

Tabela 31. Zgjedhja e të njëjtës shkollë dhe të njëjtit drejtim	46
Tabela 32. Aspektet e shkollës që janë vlerësuar sipas viteve (përqindja e të diplomuarve që i ka vlerësuar shumë/ose jashtëzakonisht shumë)	48
Tabela 33. Aspektet e shkollës që janë vlerësuar sipas rajoneve (përqindja e të diplomuarve që i ka vlerësuar shumë/ose jashtëzakonisht shumë), 2024	48
Tabela 34. Pritshmëritë për 2 vitet e ardhshme sipas viteve të diplomimit	49
Tabela 35. Pritshmëritë për 2 vitet e ardhshme sipas rajoneve, 2024	49
Tabela 36. Statusi i punësimit sipas shkollave, 2024	55
Tabela 37. Vlerësimi i elementëve të shkollës sipas drejtimeve, 2024 (% e të diplomuarve që i kanë vlerësuar shumë mirë ose jashtëzakonisht mirë)	57
Tabela 38. Të ardhurat sipas kategorive të punësimit, 2024	59
Tabela 39. Relevanca sipas kategorive të punësimit, 2024	59

Lista e grafikëve

Graf. 1 Statusi i punësimit sipas gjinisë, 2024	18
Graf. 2 Të diplomuarit e punësuar sipas viteve të diplomimit	22
Graf. 3 Kur e ke filluar punën tënde të parë pas mbarimit të shkollës sipas rajoneve, 2024	23
Graf. 4 Perceptimi i sigurisë në punën aktuale sipas rajoneve, 2024	28
Graf. 5 Të ardhurat sipas viteve të diplomimit	29
Graf. 6 Të ardhurat sipas rajoneve, 2024	30
Graf. 7 Lidhja e arsimit me punën aktuale sipas viteve të diplomimit	31
Graf. 8 Arsyet pse nuk punon në një punë që lidhet me studimet, 2024	33
Graf. 9 Përdorimi i njohurive sipas rajoneve, 2024	34
Graf. 10 Të vetëpunësuarit sipas viteve të studimit	35
Graf. 11 Numri i të punësuar në biznes, 2023 dhe 2024	36
Graf. 12 Përqindja e të diplomuarve që vazhdojnë studimet/kualifikimet e mëtejshme sipas viteve të diplomimit	37
Graf. 13 Institucion ku studion apo po trajnohesh sipas viteve të diplomimit	37
Graf. 14 Lidhja e fushës së studimeve me studimet e mëparshme sipas viteve të diplomimit	38
Graf. 15 Shkalla e papunësisë 2021-2024	40
Graf. 16 Kërkimi i një punë 4 javët e fundit sipas viteve të diplomimit	40
Graf. 17 Kërkimi i një punë 4 javët e fundit sipas rajoneve, 2024	41
Graf. 18 A ke qenë ndonjëherë i punësuar që nga mbarimi i shkollës sipas viteve të diplomimit	41
Graf. 19 Arsyet e mos kërkimit të një pune (ata që nuk kanë kërkuar punë) sipas gjinisë, 2024	43
Graf. 20 Regjistruar si punëkërkuar i papunë tek zyra e punës sipas rajoneve, 2024	44
Graf. 21 Zgjedhja e të njëjtës shkollë dhe drejtim sipas viteve të diplomimit (Pëngjigjet po)	46

Përmbledhje ekzekutive

Ky raport paraqet gjetjet e studimit kombëtar mbi gjurmimin e të diplomuarve nga shkollat e arsimit profesional për vitin 2024. Bëhet fjalë për studimin e pestë në radhë të këtij lloji, pas atij të parë të kryer për vitin 2020. Përtej paraqitjes së të dhënave të vitit 2024, raporti përfshin edhe rezultatet e studimeve të mëparshme, me qëllim ofrimin e një panorame të plotë mbi zhvillimet dhe tendencat kryesore që kanë karakterizuar aspektet e punësimit apo vazhdimin të studimit për të diplomuarit gjatë periudhës 2020–2024.

Profili demografik

Gjatë vitit 2024 u diplomuan rreth 2,851 të rinj, nga të cilët rreth 1,143 morën pjesë në studim, duke përfaqësuar një nivel pjesëmarrjeje prej 40.1%. Përbërja e kampionit reflekton strukturën e popullatës së të gjithë të diplomuarve të vitit 2024, ku 16.8% janë vajza dhe 83.2% djem. Drejtimit me përfaqësimin më të lartë, si në numrin e të anketuarve ashtu edhe në atë të të diplomuarve, janë: Shërbime mjetesh transporti (18.1%), Hoteleri–Turizëm (16.3%), Ekonomi-Biznes (11.7%), Elektroteknikë (10.3%) dhe Teknologji e Informacionit dhe Komunikimit (10.1%).

Të diplomuarit e punësuar

- Periudha 2020-2024 karakterizohet nga rritje e qëndrueshme e punësimit dhe ulje e ndjeshme e papunësisë dhe NEET, duke shfaqur një përminësim gradual të tregut të punës.
- Pjesa e të punësuarve është rritur nga 40.1% për të diplomuarit në vitin 2020 në 67.6% për vitin 2023, duke zbritur lehtësisht në 62.8% për të diplomuarit në vitin 2024. Shkalla e punësimit sipas gjinisë tregon se 65.8% e diplomuarve djem janë të punësuar, krahasuar me 47.9% të vajzave.
- 70% e të diplomuarve të punësuar e sigurojnë vendin e punës që përpara diplomimit ose mbarimit të shkollës. Kjo është një tendencë e cila vërehet gjatë gjithë periudhës 2020-2024.
- Rrjetet personale, përfshirë lidhjet familjare dhe shoqëronë, mbeten mënyra kryesore e gjetjes së punës. Për të diplomuarit në vitin 2024, 62.7% e të diplomuarve raportuan përdorimin e kësaj metode.
- Tek të diplomuarit vërehet një rritje e konsiderueshme e perceptimit të sigurnisë në punë. Përqindja e atyre që deklarojnë se ndihen “të sigurt” është rritur nga 32.9% në vitin 2023 në 43.8% në vitin 2024, ndërsa përqindja e atyre që ndihen “shumë të sigurt” është dyfishuar, duke kaluar nga 22.7% në 41.7%.
- Shpërndarja e të ardhurave mujore të të diplomuarve evidenton një rritje të ndjeshme të niveleve më të larta të pagave gjatë periudhës 2021-2024. Për të diplomuarit në vitin 2024, vetëm 8.6% e të diplomuarve raportojnë të ardhura deri në 40,000 lek, ndërsa përqindja e atyre me paga në intervalin 60,000-95,000 lek ka arritur në 35.8%. Analiza sipas drejtimeve tregon se drejtimit më të paguara, të cilat kanë përqindjet më të larta të të diplomuarve që fitojnë më shumë se 60 mijë lek të ardhura mujore, janë Hoteleri-Turizëm (62.3%) dhe Inxhinieri Softuerike (60%). Ndërkohë vetëm 20% e të diplomuarve në Shërbime sociale dhe shëndetësore arrijnë të fitojnë të ardhura mujore në këtë kategori.
- Rreth 54.5% e të diplomuarve raportojnë se aktualisht janë të punësuar në profesione që lidhen drejtpërdrejt me arsimin e ndjekur. Niveli i përputhshmërisë ndërmjet punës dhe studimeve varion sipas drejtimit. Përqindjet më të larta regjistrohen në drejtimit e Hoteleri-Turizmit (78.4%), Shërbimeve Mjetesh Transporti (71.3%) dhe Elektroteknikës (53.1%), ku një pjesë e konsiderueshme e të diplomuarve ushtrojnë profesione që korrespondojnë me formimin e tyre profesional. Të dhënat nënvizojnë se arsyet ekonomike, 34.3% dhe pamundësia për tu punësuar në profesion, 27.5% janë faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë në mos-përputhjen midis arsimimit dhe tregut të punës.

- Rreth 6% e të diplomuarve rezultojnë të vetëpunësuar. Vlerësimi i perspektivës për vazhdimësinë e aktivitetit sipërmarrës tregon një tendencë të qartë drejt konsolidimit dhe qëndrueshmërisë. Në vitin 2024, 87.1% e të vetëpunësuarve e konsiderojnë vetëpunësimin si një aktivitet afatgjatë, duke shënuar rritje në krahasim me vitin 2023 (85.2%) dhe një përmirësim të dukshëm krahasuar me nivelet më të ulëta të regjistruara në vitet 2021 (59.8%) dhe 2022 (51.9%).

Të diplomuarit që po vazhdojnë kualifikime të mëtejshme


- Për të diplomaurit në vitin 2024, përqindja e të diplomuarve që kanë zgjedhur të ndjekin studime ose kualifikime të mëtejshme pas diplomimit arriti në 18.7%, duke shënuar një rritje në krahasim me të diplomuarit në vitin 2023 (15.5%). Pjesa më e madhe e tyre vijon arsimin në universitet (93.4%), duke ruajtur rolin mbizotërues të universiteteve si institucioni kryesor për të vazhduar studimet përgjatë gjithë periudhës 2021-2024. Rreth 3.8% po vazhdojnë studimet në qendra të formimit profesional, 0.9% janë duke ndjekur Akademinë Ushtarake, të Policisë dhe të Sigurisë (respektivisht nga 0.3%), dhe 0.3% po ndjekin arsim profesional pas të mesmes.
- Rreth 66.2% e të diplomuarve që kanë zgjedhur të vazhdojnë studimet deklarojnë se drejtimit aktuale të studimeve ose trajnimeve lidhen me shkollën e tyre të mëparshme. Përputhshmëria më e lartë vihet re në drejtimit teknike dhe ato të lidhura me teknologjinë, ku të diplomuarit shfaqin prirjen më të fortë për të vijuar arsimin në të njëjtat fusha.
- Për të diplomuarit në vitin 2024, arsyeja kryesore e të diplomuarve për të ndjekur studime të mëtejshme mbetet fitimi i një kualifikimi më të lartë (62.1%). Ky tregues ka shënuar një rritje të ndjeshme krahasuar me tre vitet e mëparshme, duke arritur nivelin më të lartë të periudhës së analizuar. Kjo tregon se motivimi kryesor i të diplomuarve për të vazhduar studimet lidhet me aspiratën për avancim dhe specializim.

Të diplomuarit të cilët nuk punojnë

- Pjesëmarrja aktive e të diplomuarve në kërkimin e punës ka shfaqur luhajtje të konsiderueshme gjatë periudhës 2021–2024. Për të diplomuarit në vitin 2024 rreth një në tre (33.7%) të diplomuar të cilët nuk janë në punë apo në studime të mëtejshme janë në kërkim aktiv për të gjetur një punë një vit pas diplomimit. Ndërkohë nëse i referohemi shkallës së papunësisë (të papunëve aktiv) ajo në vitin 2024 shënoi vlerën më të ulët ndër këto vite, vetëm 6.1%, një rënie e ndjeshme krahasimisht me vitin 2020 ku shënohej vlera 22.8%.
- Përdorimi i Zyrave të Punës shënoi një rritje të dukshme (17.3%), duke treguar një orientim më të madh drejt kanaleve institucionale të kërkimit të punës. Megjithatë, kanalet informale përmes lidhjeve personale mbeten ende më të përdorura (41.8%), edhe pse kjo përqindje është pothuajse përgjysmuar krahasuar me vitin 2021 (80%).

Vlerësimi retrospektiv i të diplomuarve dhe pritshmëritë për të ardhmen

- Vlerësimi i shkollës dhe i drejtimit të studiuar tregon nivele të larta kënaqësie për të diplomuarit në vitin 2024. Rreth 87.6% e të diplomuarve deklarojnë se do të zgjidhnin të njëjtën shkollë, ndërsa 80% do të zgjidhnin të njëjtin drejtim.
- Aspektet më të vlerësuara nga të diplomuarit janë metodat e mësimdhënies, aftësitë e stafit dhe infrastruktura. Në të kundërt, këshillimi për karrierën dhe bashkëpunimi me Zyrat e Punës mbeten ndër elementet më pak të vlerësuara, duke treguar nevojën për përforcimin e lidhjes ndërmjet arsimit profesional dhe tregut të punës.
- Planet për të ardhmenet e diplomuarve lidhen kryesisht me punësimin, menjëpërqindje prej 31.9%. Shënohet një rritje e dukshme e orientimit drejt sipërmarrjes (31.8%) dhe e dëshirës për të ndjekur studime të mëtejshme (21.7%). Dëshira për emigrim mbetet e pranishme (12.1%), megjithatë në nivele më të ulëta krahasuar me vitet e para të periudhës së studimit.



1. HYRJE

Monitorimi i treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit apo të certifikuarit e një institucioni arsimor realizohet nëpërmjet ‘studimeve gjurmuese’ që ndjekin ose ‘gjurmim’ të diplomuarit pasi ata diplomohen/certifikohen. Gjurmimi i të diplomuarve është një praktikë e konsoliduar dhe standarde në sektorin e Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP) në Evropë. Të dhënat nga studimet gjurmuese përdoren për të rritur kuptueshmërinë mbi relevancën e ofertës për kualifikime duke kontribuar kështu në zhvillimin e aftësive të kërkuara nga tregu i punës dhe në pajisjen e nxënësve ose kursantëve me njohuritë dhe aftësitë e duhura.

Në Shqipëri, në përputhje me ligjin nr.15/2017 ‘Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë’, i ndryshuar dhe VKM nr. 554 datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, i ndryshuar, është institucionalizuar gjurmimi në nivel kombëtar, me Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA) përgjegjëse për kryerjen e studimeve për gjurmimin e të diplomuarve të AFP-së. Ndërkohë, institucionet ofruese të Arsimit dhe Formimit Profesional (IoAFP) janë përgjegjëse nëpërmjet Njesisë së zhvillimit për gjurmimin në nivel ofruesi.

Studimet e gjurmimit ofrojnë një tablo më të qartë të performancës së të diplomuarve dhe të certifikuarve të AFP në tregun e punës, duke matur punësimin produktiv të tyre pas përfundimit të studimeve ose trajnimit. Ato përfaqësojnë një nga burimet e rëndësishme për vlerësimin dhe mbështetjen në përmirësimin e cilësisë dhe përputhshmërisë së AFP me tregun e punës. Tematikat e gjurmimit janë të shumëllojshme, por kryesisht përfshijnë pyetje që lidhen me tranzicionin nga institucioni në tregun e punës, kushtet e punës, përputhjen midis arsimit dhe punës aktuale, si dhe vlerësimin në retrospektivë të institucionit arsimor nisur nga përvoja e të diplomuarve/certifikuarve.

Në këtë kuadër, AKPA me mbështetjen e projektit “Aftësi për Punë” (S4J) ndërmoi gjurmimin në nivel kombëtar të të diplomuarve të brezit 2023-2024 nga shkollat publike të arsimit profesional në 12 qarqet e Shqipërisë me qëllimin e përgjithshëm monitorimin e treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit nga sistemi i AP.

Objektivat specifike të gjurmimit në nivel kombëtar mund të përmbliken si më poshtë:

- Vlerësimi i statusit të përgjithshëm të punësimit të të diplomuarve nga AP;
- Vlerësimi i diferencave në statusin e punësimit sipas gjinisë, rajoneve, apo sektorit të ekonomisë;
- Identifikimi i treguesve specifikë rreth integritit në tregun e punës për të diplomuarit, si koha mesatare në gjetjen e punës së parë, mënyrat e gjetjes së punës së parë, profili i punës etj;
- Analizimi i të diplomuarve të punësuar në lidhje me tipare si relevanca e studimeve me vendin e punës, paga, kushtet e punës etj;
- Analizimi i të diplomuarve që zgjedhin të ndjekin kualifikime të mëtejshme pas diplomimit;

- Vlerësimi i institucioneve ofruese bazuar në perceptimin retrospektiv të të diplomuarve;
- Krijimi i një baze për studimet dhe analizat e mëtejshme gjurmuese në nivel kombëtar për të krijuar një standard në këtë drejtim.

1143 të diplomuar nga shkollat e arsimit profesional iu përgjigjën sondazhit të gjurmimit gjatë periudhës maj-qershor 2025 ose 11-12 muaj pas diplomimit të tyre. Ky raport përshkruan dhe analizon të dhënat dhe rezultatet e përgjithshme për rrugëtimin profesional të të diplomuarve pas mbarimit të studimeve, integrimin e tyre në tregun e punës, si dhe aspekte të tjera që mund të ndihmojnë drejt vlerësimit të orientimit drejt tregut të sistemit të AFP-së në Shqipëri. Rezultatet kryesore janë paraqitur në përputhje me objektivat e studimit të gjurmimit.

Seksioni në vijim përshkruan metodologjinë e ndjekur për gjurmimin kombëtar. Me tej analizohen në detaj rezultatet për a) kategorinë e të diplomuarve të punësuar, b) të diplomuarve që ndjekin kualifikime të mëtejshme, c) të diplomuarve pa punë, si dhe d) perceptimet mbi vlerësimin e institucioneve bazuar në vlerësimin retrospektiv të të diplomuarve. Në seksionin përfundimor jepen rezultatet e përgjithshme.

2. METODOLOGJIA

2.1 Qasja metodologjike

Për studimin e gjurmimit kombëtar të të diplomuarve nga shkollat e arsimit profesional u përdor një model hulumtimi i tërthorë ku të dhënat u mbledhën nëpërmjet pyetësorëve të standardizuar përgjatë muajve maj-qershor 2025. Popullata e cila u studiuva janë të diplomuarit në vitin 2024 nga shkollat publike të arsimit profesional.

Ky nuk është studimi i parë që kryhet për këtë target grup. Para vitit 2021, këto studime janë realizuar duke përdorur një kampion në bazë të numrit total të të diplomuarve. Në vitin 2021, duke marrë parasysh nevojat për të gjeneruar indikatorë të disagreguar në nivel rajoni, grupi social, drejtimi mësimor etj., u realizua censusi i popullatës në vend të përzgjedhjes së një kampioni. Gjatë këtij procesi madhësia e popullatës së synuar ishte e vogël në numër rreth 4101 nxënës të diplomuar nga 36 shkolla në vitin 2020. Në fund të anketimit informacioni i mbledhur mbuloi 34% të tyre. Në vitin 2022, niveli i përgjigjeve për të diplomuarit e 2021 ishte 33.6%, ndërsa në vitin 2023 për të diplomuarit e 2022 ishte 36%.

Duke pasur parasysh eksperiencën e viteve të kaluara këtë vit është kryer përsëri census për të diplomuarit e vitit 2024. Për kontaktin e të diplomuarve u përdor baza e të dhënave të disponueshme e siguruar nga AKPA. 1143 ose 40.1 % e të diplomuarve në vitin 2024 ju përgjigjën anketës së gjurmimit 11-12 muaj pas diplomimit të tyre. Popullata përfshinte 2851 nxënës që kishin mbaruar studimet gjatë vitit 2024.

2.2 Instrumenti i studimit - pyetësori

Të dhënat për studimin e gjurmimit u bazuan në një pyetësor të standardizuar të organizuar me blloqe kryesore pyetjesh ashtu si dhe gjatë pesë viteve të fundit.

Duke pasur parasysh eksperiencën e viteve të kaluara, në pyetësor u bënë disa rishikime si në lidhje me përmbajtjen dhe me mënyrën e organizimit. Megjithatë është pasur parasysh që ndryshimet e bëna të ishin të tilla që të lejohej krahasimi me të dhënat e përftuara në studimet e mëparshme.

Duke u nisur nga fakti se qëllimi kryesor i anketimit ishte të studiohej përfshirja e nxënësve të diplomuar në tregun e punës, pyetja kryesore ishte statusi i tyre në momentin e anketimit.

Grupet në të cilat ndaheshin të anketuarit ishin:

- të punësuar (të punësuar, studentë që punonin dhe studionin në të njëjtën kohë)
- të vetë-punësuar
- të papunë aktivë
- joaktivë (studentë, shtëpiakë, të dekurajuar, PAK)

Secili nga grupet kishte bllokun e pyetjeve korrespondente sipas karakteristikave përkatëse.

Disa nga pyetjet për grupin e parë dhe të dytë (të diplomuarit në marrëdhënie pune) ishin:

- koha e gjetjes së punës ose e hapjes së biznesit
- mënyra e gjetjes së punës ose e hapjes së biznesit
- përputhja e drejtimit me vendin e punës
- intervali i pagës
- dobia e njohurive të marra në shkollë në vendin e punës
- siguria dhe kënaqshmëria me vendin e punës

Për grupin e tretë ose të papunët:

- perceptimi mbi statusin
- roli i zyrave të punës për të gjetur punë

Për grupin e fundit ose të diplomuarit ekonomikisht joaktivë rëndësi të veçantë kishin si të dekurajuarit, dhe ata që po ndiqnin kualifikime të mëtejshme. Për të dekurajuarit, qëllimi ishte të merrej informacion pse ata nuk e mendonin veten të aftë për të gjetur një punë, ndërsa për ata që po ndiqnin kualifikime të mëtejshme, lloji i kualifikimit, arsyeja e ndjekjes së studimeve, si dhe lidhja e tyre me drejtimin profesional.

Për të gjithë të anketuarit pavarësisht statusit të punësimit u drejtua një grup i njëjtë pyetjesh mbi:

- nevojën për përmirësime në aspekte të veçanta në shkollë
- perspektivën e tyre për të ardhmen profesionale.

Ashtu si dhe në anketimet e mëparshme, u përdorën intervistat telefonike, me anë të një teknike të njohur si CATI (Computer-assisted telephone interviewing) në të cilën intervistuesi telefonon të anketuarin dhe regjistron përgjigjet e tij në një aplikacion kompjuterik, i cili administrohet online nëpërmjet përdorimit të Platformës Kobo Toolbox.

Për kryerjen e pyetësorit për të diplomuarit u angazhuan tre persona të cilët u trajnuan nga eksperti i metodologjisë për mënyrën e duhur të administrimit. Pyetësori zgjaste mesatarisht rreth 6 minuta.

2.3 Analizimi i të dhënave

Pas mbledhjes së të dhënave, u realizua pastrimi, tabulimi dhe analizimi i tyre duke përdorur programin statistikor SPSS. Tabulimi dhe analiza përfshijnë:

- përshkrimin deskriptiv të të dhënave nëpërmjet tabelave dhe grafikëve të ndryshëm.
- krahasimin me brezat e mëparshëm të gjurmuar.

Rezultatet janë prezantuar dhe analizuar në raport në agregat dhe sipas parashikimeve të ndarjes rajonale të optimizimit të ofruesve të AFP-së, që i ndajnë ofruesit në 4 rajone siç tregohet më poshtë.

Rajoni Verior

Dibër, Kukës,
Lezhë, Shkodër



Rajoni Qendror

Durrës, Tiranë




Rajoni Jugperëndimor

Fier, Gjirokastër,
Vlorë



Rajoni Juglindor

Berat, Elbasan,
Korçë



2.4 Kufizimet metodologjike

Bazuar në faktin që anketa duhej të ishte census të dhënat duhet të merrreshin për të tërë popullatën, por 40.1% e të diplomuarve në vitin 2024 arritën të intervistoheshin. Kjo shkallë vjen kryesisht si pasojë e kontakteve të paplota dhe të gabuara në disa raste në databazën e popullatës. Megjithatë, 40.1% e të diplomuarve është një numër me të cilin mund të kryen analiza të sakta dhe mund të nxirren përfundime pasi të dhënat janë përfaqësuese.

3. PËRSHKRIMI I DEMOGRAFISË

Studimi kombëtar për gjurmimin e të diplomuarve nga shkollat e arsimit profesional në vitin 2024 përfshiu 1,143 të diplomuar, me një nivel pjesëmarrjeje në studim prej 40.1% (llogaritur si raporti midis numrit të të anketuarve dhe totalit të të diplomuarve). Nga të anketuarit, 16.8% ishin vajza (192) dhe 83.2% djem (951). Përbindjet e pjesëmarrësve reflektojnë në mënyrë të saktë shpërndarjen gjinore të popullatës së të diplomuarve, duke treguar se kampioni është përfaqësues nga ana gjinore.

Tabela 1. Shpërndarja sipas gjinisë për totalin e të diplomuarve dhe të anketuarve, 2024

Gjinia	Të diplomuar	%	Të anketuar	%
Femra	493	17.3%	192	16.8%
Meshkuj	2,358	82.7%	951	83.2%
Total	2,851	100.0%	1,143	100.0%

Shpërndarja e të diplomuarve sipas drejtimeve mësimore tregon se drejtimit me numrin më të madh të të diplomuarve janë: Shërbime mjetesh transporti (17.9%), Hoteleri-Turizëm (16.8%), Elektroteknikë (11.2%), Teknologji Informacioni dhe Komunikimi (10.6%) dhe Ekonomi-Biznes (8.8%). Këto pesë drejtime përbëjnë mbi gjysmën e totalit të të diplomuarve (65.3%).

Në kampionin e të anketuarve vërehet një shpërndarje e ngjashme, duke reflektuar strukturën e përgjithshme të popullatës së të diplomuarve. Për shembull, Shërbime mjetesh transporti përfaqësohet me 18.1% të të anketuarve, Hoteleri-Turizëm me 16.3%, Elektroteknikë me 10.3% dhe TIK me 10.1%.

Ka disa drejtime ku pjesëmarrja në anketim nuk është gjithmonë proporcionale me popullatën, megjithatë këto përbëjnë një pjesë shumë të vogël të totalit dhe nuk ndikojnë në përfaqësueshmërinë e përgjithshme të kampionit. Megjithatë, shpërndarja e të anketuarve pasqyron në mënyrë të kënaqshme strukturën e të diplomuarve sipas profileve, duke garantuar që rezultatet e anketimit të jenë përfaqësuese në këtë aspekt.

Tabela 2. Shpërndarja sipas drejtimeve mësimore për të diplomuarit dhe të anketuarit, 2024

	Të diplomuar	%	Të anketuar	%
Shërbime mjetesh transporti (ShMT)	509	17.9%	207	18.1%
Hoteleri-Turizëm	480	16.8%	186	16.3%
Elektroteknikë	320	11.2%	118	10.3%
Teknologji Informacioni dhe Komunikimi (TIK)	302	10.6%	116	10.1%
Ekonomi-Biznes	251	8.8%	134	11.7%

	Të diplomuar	%	Të anketuar	%
Termohidraulike	184	6.5%	58	5.1%
Mekanike	156	5.5%	58	5.1%
Shërbime sociale dhe shëndetësore	123	4.3%	48	4.2%
Teknologji Ushqimore	110	3.9%	43	3.8%
Bujqësi	83	2.9%	38	3.3%
Inxhinieri informatike Softuerësh	70	2.5%	30	2.6%
Rrjete të dhënash (PILOT-GIZ)	56	2.0%	19	1.7%
Tekstil Konfeksione	52	1.8%	17	1.5%
Veterinari	43	1.5%	25	2.2%
Ndërtim	27	0.9%	15	1.3%
Shërbime Kujdesi për të moshuar (PILOT - GIZ)	21	0.7%	2	0.2%
Përpunim druri	15	0.5%	7	0.6%
Detari	12	0.4%	4	0.3%
Gjeologji	10	0.4%	5	0.4%
Kërkim, shpim, shfrytëzim, nafte, gazi dhe uji	9	0.3%	2	0.2%
Pyje	9	0.3%	6	0.5%
Gjeodezi	8	0.3%	5	0.4%
Pedagogjike	1	0.0%	0	0%
Totali	2,851	100%	1,143	100%

Nga shpërndarja sipas rajoneve të optimizimit, rezulton se pjesa më e madhe e të anketuarve i përket Rajonit Qendror, me 51.2%. Rajoni Juglindor përfaqëson 18.7% të kampionit, ndjekur nga Rajoni Jugperëndimor me 16.8% dhe Rajoni Verior me 13.3%.

Tabela 3. Shpërndarja sipas rajoneve të anketuarve, 2024

Rajonet	Të diplomuarit	% e të diplomuarve	Të anketuarit	% e të anketuarve
Rajoni Verior	378	13.3%	152	13.3%
Rajoni Qendror	1514	53.1%	585	51.2%
Rajoni Juglindor	524	18.4%	214	18.7%
Rajoni Jugperëndimor	435	15.3%	192	16.8%
Totali	2,851	100%	1,143	100%

Në kuadrin e të dhënave demografike të të anketuarve, është mbledhur informacion edhe për përfshirjen e grupeve të veçanta në arsimin profesional. Rezultatet tregojnë

se nga 1,143 të diplomuar të anketuar, 44 persona (3.8%) i përkisnin komunitetit Rom/ Egjiptian, ndërsa 11 të anketuar (1%) ishin me aftësi të kufizuara. Përveç kësaj, 11.5% e të diplomuarve të anketuar vinin nga familje përfituese të ndihmës ekonomike. Tabela më poshtë tregon shpërndarjen demografike për këto karakteristika për popullatën dhe kampionin duke dëshmuar se përbërja e kampionit është shumë e ngjashme me atë të popullatës.

Tabela 4. Të diplomuar dhe të anketuar sipas përkatësisë etnike, aftësisë së kufizuar dhe nëse janë nga familje me ndihmë ekonomike, 2024

Karakteristika demografike të të diplomuarve	Të diplomuar		Të anketuar	
	Numër	% ndaj totalit	Numër	% ndaj totalit
Rom/ Egjiptian	84	2.9%	44	3.8%
Me aftësi të kufizuar	21	0.7%	11	1%
Nga familje me ndihmë ekonomike	370	13%	132	11.5%
Total	2,851		1,143	

4. SITUATA E PUNËSIMIT E TË DIPLOMUARVE

4.1 Situata aktuale e punësimit

Periodha 2020-2024 karakterizohet nga nritje e qëndrueshme e punësimit dhe ulje e ndjeshme e papunësisë dhe NEET¹, duke treguar për një përmirësim gradual të tregut të punës.

Pjesa e të punësuarve është rritur nga 40.1% për të diplomuarit në vitin 2020 në 67.6% për vitin 2023, duke zbritur lehtësisht në 62.8% për të diplomuarit në vitin 2024. Brenda këtij grupi, punësimi (pa përfshirë këtu vetëpunësimin dhe punësimin ndërkohë që studiohet me kohë të plotë) ka pësuar nritje të vazhdueshme (nga 30.8% në 2020 në 46.6% në 2024), ndërsa vetëpunësimi ka mbetur në nivele më të ulëta dhe të qëndrueshme (mesatarisht rreth 6-7%).

Shkalla e të diplomuarve që ndjekin studime/trajnime të mëtejshme ka rënë nga 28.9% në 2020 në 18.7% për të diplomuarit në vitin 2024. Krahasuar me një vit më parë, ky tregues është rritur me 3.2 pikë përqindje.

Shkalla e papunësisë ka shënuar ulje të ndjeshme, nga 22.8% për të diplomuarit në vitin 2020 në vetëm 6.1% në vitin 2024. Pjesa e të diplomuarve që nuk janë as në punë, as në arsim apo trajnim (NEET) ka zbritur nga 31.0% në vitin 2020 në 18.5% në vitin 2024, duke reflektuar një përmirësim të dukshëm në përfshirjen e tyre në tregun e punës.

Tabela 5. Statusi i punësimit të të diplomuarve sipas kategorive dhe viteve të diplomimit


	2020	2021	2022	2023	2024
I/E punësuar	30.8%	38.3%	39.8%	48.6%	46.6%
I/E vetë-punësuar	4.4%	8.0%	6.7%	6.9%	6.0%
Punoj dhe studioj (ose trajnohem) në të njëjtën kohë	4.9%	11.2%	13.0%	12.1%	10.2%
Gjithsej të punësuar	40.1%	57.5%	59.5%	67.6%	62.8%
Student/kursant në trajnim të mëtejshëm	28.9%	23.5%	23.1%	15.5%	18.7%
Total te punësuar ose në studime	69.0%	81.0%	82.6%	83.1%	81.5%
Pa punë dhe po kërkoj për punë	22.8%	7.7%	10.3%	8.4%	6.1%
Pa punë por nuk kërkoj për punë	7.1%	10.8%	7.1%	3.1%	7.7%
Inaktivë të tjetrë	1.1%	0.5%	0.1%	5.5%	4.7%
As në punësim as në arsim apo trajnim (NEET)	31.0%	19.0%	17.5%	17.0%	18.5%
Totali	100%	100%	100%	100%	100%



1 Të rinjtë të cilët nuk janë të përfshirë as në punësim as në studime/trajnime të mëtejshme.

Të dhënat për të diplomuarit në 2024 sipas gjinisë tregojnë se punësimi është më i lartë tek djemtë (65.8%) krahasuar me vajzat (47.9%). Për sa i përket vijimit të studimeve apo trajnimeve të mëtejshme, rezultojnë se 25.5% e vajzave dhe 17.4% e djemve janë të përfshirë në këtë kategori, duke treguar se vajzat kanë një tendencë më të lartë për të vijuar studimet e mëtejshme. Ndërkohë, shkalla e të rinjve që nuk janë as në punësim, as në arsim apo trajnim (NEET) është më e lartë tek vajzat (26.6%) sesa tek djemtë (16.8%).

Graf. 1 Statusi i punësimit sipas gjinisë, 2024



Analiza sipas rajoneve dëshmon për dallime në statusin e të diplomuarve sipas rajoneve. Në Rajonin Qendror rezultojnë përqindja më e lartë e punësimit dhe përfshirjes në arsim/trajnim (88.7%), ndërsa Rajoni Verior (71.1%), Juglindor (72.0%) dhe Jugperëndimor (78.6%) paraqesin nivele më të ulëta në krahasim. Shkalla e të rinjve që nuk janë as në punësim, as në arsim apo trajnim (NEET) luhet nga 11.3% në Rajonin Qendror deri në 28.9% në Rajonin Verior dhe 28.0% në Rajonin Juglindor. Ndërkohë, përqindja e të vetëpunësuarve është më e lartë në Rajonin Jugperëndimor (10.4%), krahasuar me nivelet më të ulëta në rajonet e tjera. Gjithashtu, të diplomuarit në punësim dhe njëkohësisht në studim/trajnim është dukshëm më i përhapur në Rajonin Qendror (15.6%) sesa në rajonet e tjera.

Tabela 6. Statusi i punësimit sipas rajoneve, 2024

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor
I/e punësuar	50.7%	45.6%	42.1%	51.6%
I/e vetë-punësuar	4.6%	5.0%	6.1%	10.4%
Punoj dhe studioj (ose trajnohem) në të njëjtën kohë	6.6%	15.6%	6.1%	1.0%
Të punësuar gjithsej	61.8%	66.2%	54.2%	63.0%
Në arsim (studime apo trajnime të mëtejshme)	9.2%	22.6%	17.8%	15.6%
Total te punësuar ose në studime	71.1%	88.7%	72.0%	78.6%

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor
Pa punë dhe po kërkoj për punë	10.5%	4.4%	6.5%	6.8%
Pa punë por nuk kërkoj për punë	11.8%	4.1%	12.6%	9.9%
Tjetër	6.6%	2.7%	8.9%	4.7%
NEET	28.9%	11.3%	28.0%	21.4%
Totali	100.00%	100.00%	100.00%	100.00%

4.2 Analiza e statusit të punësimit sipas drejtimeve dhe shkollave

Shumica e të diplomuarve të arsimit profesional janë të angazhuar ose në punë, ose në studime të mëtejshme, megjithatë disa drejtime specifike shfaqin nivel më të lartë të papunësisë ose të mos-angazhimit në studime.

Pjesëmarrja në punësim ose në studim për të diplomuarit në arsimin profesional është e lartë, përkatësisht 62.8% të tyre të punësuar dhe 18.7% në studime të mëtejshme, duke rezultuar në një 81.5% total të përfshirjes në punësim ose në studime. Drejtimet si Hoteleri-Turizëm, Mekanikë dhe Shërbim Mjetesh Transporti shfaqin norma të larta punësimi. Ndërsa sektorë të tjerë, si Pyje, Tekstil-Konfeksione, Veterinari dhe Shërbime Sociale dhe Shëndetësore përballen me nivele të larta të NEET (as në punësim apo arsim).

Tabela 7. Statusi i punësimit sipas drejtimeve, 2024

	Të punësuar	Studime të mëtejshme	Total të punësuar ose në studime	NEET	Total të anketuar ²
Bujqësi	68.4%	15.8%	84.2%	15.8%	38
Detari	100.0%	-	100.0%	-	4
Ekonomi- Biznes	57.5%	27.6%	85.1%	14.9%	134
Elektroteknikë	57.6%	20.3%	78.0%	22.0%	118
Gjeodezi	60.0%	40.0%	100.0%	0.0%	5
Gjeologji	40.0%	-	40.0%	60.0%	5
Hoteleri-Turizëm	78.5%	5.4%	83.9%	16.1%	186
Inxhinieri Informatike Softwaresh	43.3%	50.0%	93.3%	6.7%	30
Kërkim, shpim, shfrytëzim, nafte, gazi dhe uji	50.0%	-	50.0%	50.0%	2



2 Shënim: Interpretimi i shifrave të vogla duhet bënë me rezervë.

	Të punësuar	Studime të mëtejshme	Total të punësuar ose në studime	NEET	Total të anketuar ²
Mekanike	72.4%	12.1%	84.5%	15.5%	58
Ndërtim	60.0%	6.7%	66.7%	33.3%	15
Përpunim druri	71.4%	14.3%	85.7%	14.3%	7
Pyje	16.7%	-	16.7%	83.3%	6
Rrjete te dhënash (PILOT GIZ)	63.2%	36.8%	100.0%	0.0%	19
Shërbim mjetesh transporti	71.5%	12.6%	84.1%	15.9%	207
Shërbime kujdesi për te moshuar (PILOT GIZ)	50.0%	50.0%	100.0%	-	2
Shërbimë Sociale dhe Shëndetësore	31.3%	35.4%	66.7%	33.3%	48
Teknologji Informacioni dhe Komunikimi	52.6%	31.0%	83.6%	16.4%	116
Teknologji Ushqimore	72.1%	9.3%	81.4%	18.6%	43
Tekstil-Konfeksione	23.5%	29.4%	52.9%	47.1%	17
Termohidraulike	69.0%	15.5%	84.5%	15.5%	58
Veterinari	36.0%	24.0%	60.0%	40.0%	25
Totali	62.8%	18.7%	81.5%	18.5%	1,143

4.3 Grupet vulnerabël

Të dhënat sipas grupeve vulnerabël (Romë/Egjiptianë, persona me aftësi të kufizuara dhe të diplomuar nga familje përfituese të ndihmës ekonomike) tregojnë dallime të dukshme në nivelet e punësimit dhe përfshirjes në arsim apo trajnim.

Shkalla e punësimit ndër të diplomuarit Rom/Egjiptian është rritur nga 53.4% në vitin 2022 në 67.7% në vitin 2023, për t'u stabilizuar në 65.9% në vitin 2024. Megjithatë, pjesëmarrja në arsim/trajnim pas diplomimit ka rënë ndjeshëm (nga 33.3% në 2022 në vetëm 11.4% në 2024). Si rrjedhojë, përqindja e përgjithshme e të përfshirëve në punësim ose arsim ka rënë nga 86.7% në vitin 2022 në 77.3% në vitin 2024, ndërsa NEET është rritur nga 13.3% në 2022 në 22.7% në 2024.

Ndër të diplomuarit me aftësi të kufizuara vëmë re se ata kanë shkallën më të ulët të punësimit dhe pjesëmarrjes në arsim të mëtejshëm. Në vitin 2022 vetëm 28.6% ishin të përfshirë në punë ose arsim, përqindje që u rrit në 38.9% në vitin 2023 dhe në 54.5% në vitin 2024.

Shkalla e përfshirjes në punë ose arsim e të diplomuarve nga familje me ndihmë ekonomike paraqesin luhajtje, duke qenë 73.1% në 2022, 76.4% në 2023 dhe 68.2% në 2024.

Tabela 8. Statusi i punësimit sipas grupeve vulnerabël sipas viteve

	Vitet e studimit	Të punësuar gjithsej	Në arsim (studime apo trajnime të mëtejshme)	Total te punësuar ose në studime	NEET	Total të anketuar ³
Rom / Egjiptian	2022	53.4%	33.3%	86.7%	13.3%	30
	2023	67.7%	14.7%	82.4%	17.6%	34
	2024	65.9%	11.4%	77.3%	22.7%	44
Aftësi e kufizuar	2022	14.3%	14.3%	28.6%	71.4%	7
	2023	33.3%	5.6%	38.9%	61.1%	18
	2024	36.4%	18.2%	54.5%	45.5%	11
Ndihmë ekonomike	2022	47.2%	25.9%	73.1%	26.9%	216
	2023	59.3%	17.1%	76.4%	23.6%	165
	2024	52.3%	15.9%	68.2%	31.8%	132




3 Shënim: Interpretimi i shifrave të vogla duhet bënë me rezerva.

5. TË DIPLOMUARIT E PUNËSUAR

Të dhënat mbi punësimin e të diplomuarve në arsimin profesional tregojnë një rritje të dukshme gjatë periudhës 2020-2024. Për të diplomuarit në vitin 2020, rreth 40.1% e të diplomuarve ishin të punësuar, ndërsa kjo përqindje u rrit në 57.5% për vitin 2021 dhe 59.5% për vitin 2022. Niveli më i lartë u arrit për të diplomuarit në vitin 2023, me 67.6% të të diplomuarve të punësuar. Për vitin 2024 vihet re një rënie e lehtë, me 62.8% të të diplomuarve të punësuar, megjithatë treguesi mbetet dukshëm më i lartë krahasuar me vitin 2020.

Graf. 2 Të diplomuarit e punësuar sipas viteve të diplomimit



5.1 Tranzicioni drejt tregut të punës – koha e gjetjes së punës së parë për të punësuarit

Të dhënat e vitit të fundit tregojnë se 70.0% e të diplomuarve që punësohen e sigurojnë vendin e punës që përpara diplomimit ose mbarimit të shkollës. Kjo është një prirje e cila vërehet gjatë gjithë periudhës 2020-2024.

Pas diplomimit, 22.9% u punësuan brenda 6 muajsh, dhe 7.2% e të diplomuarve u punësuan mbi 6 muaj pas diplomimit. Kjo shpërndarje tregon një nivel të lartë punësimi të hershëm, ndërsa përqindja e atyre që hyjnë në tregun e punës pas 6 muajsh mbetet relativisht e ulët.


Analiza gjinore tregon se më shumë djemtë se vajzat e kanë gjetur punën e tyre që para diplomimit, respektivisht 71.1% për meshkujt dhe 62.3% për femrat.

Tabela 9. Kur e ke filluar punën tënde të parë pas mbarimit të shkollës sipas viteve të diplomimit

	2020	2021	2022	2023	2024
Që para diplomimit/ mbarimit të shkollës	60.5%	57.5%	58.4%	21.9%	70.0%
1 muaj pas diplomimit	10.3%	21.6%	17.6%	11.8%	7.4%
1 - 3 muaj pas diplomimit	18.9%	11.4%	8.3%	21.0%	9.0%
3 - 6 muaj pas diplomimit	8.0%	5.1%	7.1%	14.0%	6.5%
6 - 9 muaj pas diplomimit	1.6%	2.2%	3.0%	8.8%	3.6%
9 - 12 muaj pas diplomimit	0.6%	2.2%	5.5%	22.5%	3.6%

Rezultatet rajonale tregojnë se shumica e të diplomuarve arrijnë të punësohen menjëherë ose shumë shpejt pas mbarimit të shkollës, çka sugjeron një lidhje të fortë mes arsimit dhe tregut të punës. Në të gjitha rajonet e vendit të diplomuarit e punësuar kanë filluar punën e tyre të parë që para diplomimit. Ky fenomen është më i theksuar në Rajonin Jugperëndimor (84.0%) dhe Rajonin Juglindor (76.5%), ndërsa përqindjet janë disi më të ulëta në Rajonin Verior (69.2%) dhe Rajonin Qendror (65.2%).

Graf. 3 Kur e ke filluar punën tënde të parë pas mbarimit të shkollës sipas rajoneve, 2024



Një pjesë e konsiderueshme e të diplomuarve të arsimit profesional arrijnë të gjejnë punën e tyre të parë shumë shpejt pas përfundimit të shkollës. Duke u fokusuar te drejtime me më shumë të diplomuar mund the themi se drejtimet Ekonomi-Biznes (89.6%), Hoteleri-Turizëm (92.7%), SHMT (98.2%) dhe TIK (91.1%) arrijnë të gjejnë punë që në 6 muajin e parë pas diplomimit.

Tabela 10. Puna e parë pas mbarimit të shkollës sipas drejtimit, 2024

	Që para diplomimit/ mbarimit të shkollës	1 - 6 muaj pas diplomimit	6 -12 muaj pas diplomimit
Bujqësi	50.0%	36.4%	13.6%
Detari	75.0%	25.0%	0.0%
Ekonomi- Biznes	79.3%	10.3%	10.3%
Elektroteknikë	78.2%	12.7%	9.1%
Gjeodezi	66.7%	0.0%	33.3%
Gjeologji	100.0%	0.0%	0.0%
Hoteleri-Turizëm	70.7%	22.0%	7.3%
Inxhinieri Informatike Softwaresh	45.5%	45.5%	9.1%
Kërkim, shpim, shfrytëzim, nafte, gazi dhe uji		100.0%	0.0%
Mekanike	81.5%	18.5%	0.0%
Ndërtim	50.0%	50.0%	0.0%
Përpunim druri	40.0%	60.0%	0.0%
Pyje		100.0%	0.0%
Rrjete te dhënash (PILOT GIZ)	8.3%	91.7%	0.0%
Shërbim mjetesh Transporti	81.5%	16.7%	1.9%
Shërbime kujdesi për te moshuar (PILOT GIZ)		0.0%	100.0%
Shërbime Sociale dhe Shëndetësore	81.8%	18.2%	0.0%
Teknologji Informacioni dhe Komunikimi	71.1%	20.0%	8.9%
Teknologji Ushqimore	27.3%	59.1%	13.6%
Tekstil -Konfeksione	50.0%	0.0%	50.0%
Termodinamike	76.5%	14.7%	8.8%
Veterinari	40.0%	40.0%	20.0%
Totali	70.0%	22.8%	7.2%

5.2 Mënyra e gjetjes së punës së parë

Analiza e mënyrave të gjetjes së punës nga të diplomuarit gjatë viteve 2020-2024 tregon ndryshime të dukshme në kanalet e përdorura, me një mbizotënim në përdorim të rrjeteve sociale dhe lidhjeve personale.

Rrjetet personale, përfshirë lidhjet familjare dhe shoqërore, mbeten mënyra kryesore e punësimit. Të dhënat sipas viteve tregojnë se në vitin 2020, 58.2% e të diplomuarve deklarorin se e përdornin këtë mënyrë për të gjetur punë. Një vit më vonë, në vitin 2021 kjo përqindje u rrit në 81.5% për të zbritur në 2023 në 47.4%. Ndërkohë në vitin 2024 vihet re një rritje e lehtë, ku 62.7% e të diplomuarve raportuan përdorimin e njohjeve për të gjetur punën aktuale.

Përgjigjet ndaj lajmërimeve të publikuara në internet, media sociale, shfaqin një rritje të përgjithshme, duke kaluar nga 3.3% në vitin 2020 në maksimum 20.5% në vitin 2023, për t'u ulur në 11.5% në vitin 2024. Praktikave profesionale në biznes kanë mbajtur një nivel relativisht të qëndrueshëm gjatë periudhës, midis 4.1% dhe 11.9%.

Analiza gjinore tregon se më shumë djemtë e kanë gjetur punën me anë të praktikave në biznes, 11.5% në krahasim me 5.7% të vajzave. Gjithashtu më shumë djem se vajza kanë përdorur njohjet dhe lidhjet familjare, 63.3% në krahasim me 58.6%. Nga ana tjetër më shumë vajza se djem i janë përgjigjur lajmërimeve në faqe interneti apo rrjete sociale, 15.7% për vajzat dhe 10.9% për djemtë.

Tabela 11. Mënyra e gjetjes së punës sipas viteve të diplomimit

	2020	2021	2022	2023	2024
Nëpërmjet Zyrës së Punës	0.8%	0.5%	0.2%	0.8%	0.5%
Nëpërmjet përgjigjes së lajmërimeve të publikuara në faqe interneti, media sociale, gazetë etj.	3.3%	7.1%	12.0%	20.5%	11.5%
Nga praktika profesionale në biznes	9.6%	4.1%	11.9%	11.1%	10.8%
Nëpërmjet njohjeve, lidhjeve familjare, miqve, të njohurve	58.2%	81.5%	64.3%	47.4%	62.7%
Duke kontaktuar drejtpërdrejtë me punëdhënësin tim (duke dërguar CV etj.)	24.7%	5.8%	6.1%	18.6%	7.4%
Nga mësuesit/instruktorët në shkollë	1.9%	0.6%	2.7%	1.2%	5.0%
Tjetër	1.4%	0.3%	2.9%	0.4%	2.0%

Analiza rajonale tregon se në të gjitha rajonet e vendit, rrjeti i njohjeve, lidhjeve familjare, miqve dhe të njohurve mbetet mënyra kryesore për gjetjen e punës për të diplomuarit në arsimin profesional. Përqindjet luhaten nga 55.1% në Rajonin Verior deri në 66.7% në Rajonin Jugperëndimor.

Një pjesë e konsiderueshme e të punësuarve, veçanërisht në Rajonin Verior (24.4%), kanë gjetur punën përmes praktikave profesionale në biznes, ndërkohë që kjo mënyrë është pothuajse e papërfillshme në Juglindje (2.4%).

Përgjigjja ndaj lajmërimeve të publikuara në internet, rrjete sociale apo media përbën një tjetër kanal të rëndësishëm, sidomos në Rajonin Qendror (13.8%), ndërsa përqindjet janë më të ulëta në Jugperëndim (6.7%).

Një veçori dalluese haset në Rajonin Juglindor, një pjesë e konsiderueshme e të punësuarve (20.5%) e kanë gjetur punën përmes mësuesve apo instruktorëve në shkollë, një përqindje shumë më e lartë se në rajonet e tjera (2–5%).

Ndërkohë, kontaktimi i drejtpërdrejtë me punëdhënësit ka qenë më i shprehur në Rajonin Qendror (10.3%), krahasuar me nivele më të ulëta në rajonet e tjera (2–5%).

Tabela 12. Mënyra e gjetjes së punës sipas rajoneve, 2024

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Jugperëndimor	Rajoni Juglindor
Nëpërmjet Zyrës së Punës	1.3%	0.3%	1.3%	0.0%
Nëpërmjet përgjigjes së lajmërimeve të publikuara në faqe interneti, media sociale, gazetë etj.	9.0%	13.8%	6.7%	9.6%
Nga praktika profesionale në biznes	24.4%	8.8%	14.7%	2.4%
Nëpërmjet njohjeve, lidhjeve familjare, miqve, të njohurve	55.1%	63.0%	66.7%	65.1%
Duke kontaktuar drejtpërdrejtë me punëdhënësin tim (duke dërguar CV etj.)	5.1%	10.3%	2.7%	2.4%
Nga mësuesit/instruktorët në shkollë	2.6%	1.6%	5.3%	20.5%
Tjetër	2.6%	2.2%	2.6%	0.0%

5.3 Karakteristikat kryesore në punën aktuale

Në përgjithësi, të dhënat tregojnë se punësimi i të diplomuarve vazhdon të jetë i përqendruar në ndërmarrjet mikro dhe të vogla. Ndërmarrjet mikro (1-9 të punësuar) mbeten segmenti më i përdorur në vitet 2021 dhe 2023 (58.9% dhe 66.0%), megjithatë në vitin 2024 përqindja bie në 44.2%. Ndërmarrjet e vogla (10-49 të punësuar) kanë pasur një rritje të moderuar gjatë periudhës, duke arritur 33.1% në vitin 2024.

Tabela 13. Numri i punonjësve në kompaninë ku të diplomuarit punojnë sipas viteve të diplomimit

	2021	2022	2023	2024
Ndërmarrje Mikro (1-9 të punësuar)	58.9%	42.2%	66.0%	44.2%
Ndërmarrje e Vogël (10-49 të punësuar)	27.8%	31.8%	29.7%	33.1%
Ndërmarrje e Mesme (50-249 të punësuar)	9.2%	13.6%	3.3%	16.4%
Ndërmarrje e Madhe (250+ të punësuar)	4.1%	12.3%	1.0%	6.4%

Kontratat me afat të caktuar kanë pësuar një rënie të vazhdueshme, nga 55.3% në vitin 2021 në 14.7% në vitin 2024. Ndërkohë, kontratat pa afat kanë shënuar një rritje të qëndrueshme, duke arritur 64.4% në vitin 2024, që tregon një përmirësim të sigurnisë së punës për të diplomuarit.

Përqindja e të diplomuarve pa kontratë (të pa përfshirë në marrëveshje të formalizuara) ka pësuar ulje nga 36.3% në vitin 2023 në 20.9% në vitin 2024. Ky trend reflekton një zhvendosje të dukshme drejt punësimit formal dhe të qëndrueshëm, me një ulje të punësimit të paformalizuara dhe kontratave të përkohshme.

Tabela 14. Lloji i kontratës së punës sipas viteve të diplomimit

	2021	2022	2023	2024
Kontratë me afat të caktuar	55.3%	17.0%	20.3%	14.7%
Kontratë pa afat	18.4%	44.0%	43.5%	64.4%
Po bëj praktikë	1.1%	1.7%		
Jam pa kontratë (Nuk kam nënshkruar kontratë)	25.1%	37.2%	36.3%	20.9%

Pjesa më e madhe e të diplomuarve ka shfaqur një rritje të ndjeshme të sigurisë në punë: përqindja e atyre që ndihen 'i/e sigurt' ka kaluar nga 32.9% në vitin 2023 në 43.8% në vitin 2024, ndërsa ata që ndihen 'shumë i/e sigurt' janë rritur nga 22.7% në 41.7%.

Në të kundërt, të diplomuarit që raportuan pasiguri të lartë ('shumë i/e pasigurt' dhe 'i/e pasigurt') janë ulur nga 16.8% në vitin 2021 në vetëm 8.0% në vitin 2024. Përqindja e të diplomuarve neutralë ka rënë ndjeshëm, nga 47.0% në vitin 2021 në 6.5% në vitin 2024. Ky trend tregon një rritje të qartë të sigurisë së të diplomuarve në vendin e punës gjatë periudhës 2021-2024.


Tabela 15. Perceptimi i sigurisë në punën aktuale sipas viteve të diplomimit

	2021	2022	2023	2024
Shumë i/e pasigurt	7.8%	1.4%	1.1%	4.3%
I/e pasigurt	9.0%	1.3%	3.9%	3.7%
As i sigurt as i pasigurt/ neutral	47.0%	15.4%	39.4%	6.5%
I/e sigurt	23.5%	34.2%	32.9%	43.8%
Shumë i/e sigurt	12.7%	47.7%	22.7%	41.7%

Të dhënat tregojnë se niveli i sigurisë në punën aktuale perceptohet ndryshe midis rajoneve. Në Rajonin Qendror, pjesa më e madhe e të diplomuarve të punësuar (92.1%) shprehen se ndihen shumë të sigurt ose të sigurt, duke e renditur këtë rajon me treguesin më të lartë të sigurisë në punën aktuale. Në këtë rajon niveli i pasigurisë është minimal (3.6%) dhe pjesa neutrale pothuajse e papërfillshme (4.3%). Në Rajonin Verior dhe Rajonin Juglindor, niveli i sigurisë së perceptuar është gjithashtu i lartë, përkatësisht 78.9% dhe 78.8%.

Ndërkohë në Rajonin Jugperëndimor 73.0% e të anketuarve e konsiderojnë veten të sigurt ose shumë të sigurt në punën aktuale, ndërsa 20.3% shprehen të pasigurt. Ky është niveli më i lartë i pasigurisë ndër të gjitha rajonet e vendit.

Graf. 4 Perceptimi i sigurisë në punën aktuale sipas rajoneve, 2024



Analiza sipas drejtimeve tregon se pjesa më e madhe e të diplomuarve të arsimit profesional që janë të punësuar ndihen të sigurt në punën e tyre, duke reflektuar një përshtatje të mirë midis kualifikimeve dhe kërkesave të tregut të punës. Drejtimet me perceptim sigurie të lartë mbi 90% janë Hoteleri-Turizëm (94.8%), Gjeodezi, Inxhinieri Informatike Softwaresh, Kërkim/Shfrytëzim nafte, Pyje, Rnjete të dhënash, Shërbim për të moshuar, Tekstil-Konfeksione, Veterinari (100%). Ndërkohë drejtime të tjera kanë përqindje të sigurisë 70-90% ku specifikisht: Elektroteknikë (87.3%), Ndërtim (83.3%), Përpunim druri (80%), Shërbim mjetesh Transporti (85.8%), Teknologji Ushqimore (85%), Termohidraulike (81.8%), Teknologji Informacioni dhe Komunikimi (76.7%), Ekonomi-Biznes (71.4%), Shërbime Sociale dhe Shëndetësore (70%).

Tabela 16. Perceptimi i sigurisë në punën aktuale sipas drejtimeve

	Shumë i/e pasigurt ose i/e pasigurt	As i sigurt as i pasigurt/ neutral	Shumë i/e sigurt ose i/e sigurt
Bujqësi	10.5%	0.0%	89.5%
Detari	0.0%	25.0%	75.0%
Ekonomi- Biznes	19.6%	8.9%	71.4%
Elektroteknikë	10.9%	1.8%	87.3%
Gjeodezi	0.0%	0.0%	100.0%
Gjeologji	0.0%	100.0%	0.0%
Hoteleri-Turizëm	2.6%	2.6%	94.8%
Inxhinieri Informatike Softwaresh	0.0%	0.0%	100.0%
Kërkim, shpim, shfrytëzim, nafte, gazi dhe uji	0.0%	0.0%	100.0%
Mekanike	14.8%	7.4%	77.8%
Ndërtim	0.0%	16.7%	83.3%

	Shumë i/e pasigurt ose i/e pasigurt	As i sigurt as i pasigurt/ neutral	Shumë i/e sigurt ose i/e sigurt
Përpunim druri	20.0%	0.0%	80.0%
Pyje	0.0%	0.0%	100.0%
Rrjete të dhënash (PILOT GIZ)	0.0%	0.0%	100.0%
Shërbim mjeteve Transporti	8.5%	5.7%	85.8%
Shërbime kujdesi për të moshuar (PILOT GIZ)	0.0%	0.0%	100.0%
Shërbime Sociale dhe Shëndetësore	10.0%	20.0%	70.0%
Teknologji Informacioni dhe Komunikimi	9.3%	14.0%	76.7%
Teknologji Ushqimore	0.0%	15.0%	85.0%
Tekstil -Konfeksione	0.0%	0.0%	100.0%
Termohidraulike	6.1%	12.1%	81.8%
Veterinari	0.0%	0.0%	100.0%
Totali	8.0%	6.5%	85.5%

5.4 Integrimi në tregun e punës – Të ardhurat

Shpërndarja e të ardhurave mujore të të diplomuarve tregon një rritje të dukshme të pagave më të larta gjatë periudhës 2021-2024. Përqindja e të diplomuarve me paga deri në 40,000 lek ka rënë nga 39.8% për të diplomuarit në vitin 2021 në vetëm 8.6% për të diplomuarit në vitin 2024, ndërsa ata në grupin mbi 60,000 lek janë rritur ndjeshëm, nga 9.9% në 51.9%.

Ky trend dëshmon për një zhvendosje të përgjithshme drejt të ardhurave më të larta dhe një përminësim të standardit të pagave për të diplomuarit gjatë periudhës 2021-2024.


Graf. 5 Të ardhurat sipas viteve të diplomimit



Të dhënat tregojnë një përqendrim më të lartë të të ardhurave mbi mesatare në rajonet Qendror dhe Jugperëndimor, ndërsa rajonet Verior dhe Juglindor paraqesin më shumë të punësuar me paga më të ulëta.

Më konkretisht, Rajoni Verior ka një përqindje më të lartë të të punësuarve me paga deri në 40,000 lek (17.3%), ndërsa në Rajonin Qendror kjo kategori përfaqësohet vetëm me 5.0%. Për grupin më të lartë të pagave, mbi 60,000 lek, Rajoni Qendror ka përqindjen më të lartë (55.9%), i ndjekur nga Rajoni Jugperëndimor (51.6%) dhe Rajoni Juglindor (47.9%), ndërsa Rajoni Verior ka 40.7%.

Graf. 6 Të ardhurat sipas rajoneve, 2024



Për të analizuar nivelin e të ardhurave të fituara nga puna sipas drejtimeve kryesore, drejtimet Hoteleri-Turizëm dhe Inxhinieri Softuerësh paraqiten si drejtimet më të paguara ku më shumë se gjashtë në dhjetë të diplomuar në Hoteleri-Turizëm (62.3%), Inxhinieri Softuerësh (60%) fitojnë mbi 60 mijë lek të ardhura mujore.

Nga ana tjetër, drejtime si Bujqësi, Veterinari dhe Shërbime Sociale e Shëndetësore kanë një shpërndarje më të balancuar, ku një pjesë e konsiderueshme e të diplomuarve ka paga deri në 40,000 lek dhe në grupin e të ardhurave 40-60 mijë lek. Të dhënat tregojnë se pagat më të larta janë të përqendruara në profile teknike dhe të specializuara, ndërsa profilet tradicionale ose sociale mbeten me të ardhura më të ulëta.

Tabela 17. Të ardhurat sipas drejtimit, 2024


	Deri në 40.000 lek	40.001-60.000 lek	Mbi 60.000 lek
Bujqësi	26.3%	26.3%	47.4%
Detari	0.0%	50.0%	50.0%
Ekonomi- Biznes	21.3%	45.9%	32.8%
Elektroteknikë	15.0%	36.7%	48.3%
Gjeodezi	0.0%	33.3%	66.7%
Gjeologji	0.0%	50.0%	50.0%
Hoteleri-Turizëm	6.6%	31.1%	62.3%

	Deri në 40.000 lek	40.001-60.000 lek	Mbi 60.000 lek
Inxhinieri Informatike Softwaresh	10.0%	30.0%	60.0%
Kërkim, shpim, shfrytëzim, nafte, gazi dhe uji	0.0%	100.0%	0.0%
Mekanike	8.8%	32.4%	58.8%
Ndërtim	14.3%	28.6%	57.1%
Përpunim druri	0.0%	20.0%	80.0%
Pyje	0.0%	100.0%	0.0%
Rrjete te dhënash (PILOT GIZ)	0.0%	16.7%	83.3%
Shërbim mjetesh Transporti	5.9%	33.1%	61.0%
Shërbime kujdesi për te moshuar (PILOT GIZ)	0.0%	100.0%	0.0%
Shërbime Sociale dhe Shëndetësore	40.0%	40.0%	20.0%
Teknologji Informacioni dhe Komunikimi	6.3%	56.3%	37.5%
Teknologji Ushqimore	0.0%	54.2%	45.8%
Tekstil -Konfeksione	25.0%	25.0%	50.0%
Termohidraulike	8.1%	51.4%	40.5%
Veterinari	42.9%	14.3%	42.9%
Totali	10.3%	18.0%	37.8%

5.5 Përputhja e arsimit me punën aktuale

Analiza e lidhjes së arsimit me punën aktuale tregon se, gjatë periudhës 2020–2024, një pjesë e konsiderueshme e të diplomuarve punojnë në fusha të lidhura me arsimin e tyre. Për të diplomuarit, në vitin 2024, 54.5% e të diplomuarve të cilët punojnë raportuan se puna e tyre është e lidhur me arsimin e ndjekur.

Graf. 7 Lidhja e arsimit me punën aktuale sipas viteve të diplomimit⁴



4 Grafiku përfshin tre kategoritë e punësimit; të punësuarit, të vetëpunësuarit dhe punoj/studioj


Relevanca e punës dhe studimeve shfaq luhatje sipas drejtimeve. Duke u fokusuar tek drejtimit me më shumë të diplomuar mund të themi se ndër to drejtimet e Elektroteknikës (53.1%), Hoteleri-Turizëm (78.4%), Shërbime mjetesh transporti (71.3%) kanë pjesën më të madhe të të diplomuarve që po kryejnë një punë që lidhet me studimet e kryera gjatë arsimit profesional.

Tabela 18. Lidhja e arsimit me punën aktuale sipas kategorive të punësimit, 2024

	A lidhet/është e ngjashme puna që bën me atë që ke studiuar?		
	Të punësuar dhe ata që punojnë dhe studiojnë	Të vetëpunësuar	Total
	Vetëm përgjigjet Po		
Bujqësi	8.7%		8.3%
Detari	0.0%		0.0%
Ekonomi -Biznes	31.0%	50.0%	32.3%
Elektroteknikë	56.4%	33.3%	53.1%
Gjeodezi	66.7%		66.7%
Gjellogji	100.0%	0.0%	50.0%
Hoteleri-Turizëm	79.2%	66.7%	78.4%
Inxhinieri informatike Softwaresh	63.6%	50.0%	61.5%
Kërkim, shpim, shfrytëzim, nafte, gazi dhe uji	0.0%		0.0%
Mekanike	60.7%	62.5%	61.1%
Ndërtim	50.0%		42.9%
Përpunim druri	40.0%		40.0%
Pyje	0.0%		0.0%
Rrjete te dhënash (PILOT-GIZ)	16.7%		16.7%
Shërbime kujdesi për të moshuar (PILOT - GIZ)	0.0%		0.0%
Shërbime mjetesh transporti	69.4%	85.7%	71.3%
Shërbime sociale dhe shëndetësore	36.4%		36.4%
Teknologji Informacioni dhe Komunikimi	29.5%	80.0%	34.7%
Teknologji Ushqimore	33.3%	25.0%	32.1%
Tekstil Konfeksione	50.0%	50.0%	50.0%
Termohidraulike	54.3%	60.0%	55.0%
Veterinari	33.3%		25.0%
Totali	54.3%	56.7%	54.5%

Rezultatet tregojnë se arsyeja kryesore pse të diplomuarit e punësuar nuk punojnë në fushën e studimeve të tyre lidhet me **motivimet ekonomike**. Konkretisht, **34.3%** e tyre deklarojnë se puna aktuale u ofron **pagë ose kushte më të mira**, duke theksuar rëndësinë e përfitimeve materiale ndaj përputhjes profesionale. Nga ana tjetër, një pjesë e konsiderueshme, 27.5%, nuk kanë gjetur vende pune që lidhen me studimet e tyre, çka tregon vend për përmirësim për të rritur përputhjen midis studimeve dhe tregut të punës.

Graf. 8 Arsytet pse nuk punon në një punë që lidhet me studimet, 2024⁵



Pothuajse gjysma e të diplomuarve të punësuar po i përdorin shumë/jashtëzakonisht shumë njohuritë e marra gjatë studimeve në punën aktuale, 49.1%. Analiza e përdorimit të njohurive sipas gjinisë tregon se më shumë djem se vajza kanë deklaruar se po i përdorin shumë ose jashtëzakonisht shumë njohuritë e fituara në shkollë në punën aktuale, përkatësisht 50.4% për djemtë dhe 38.4% për vajzat.

Tabela 19. Përdorimi i njohurive të marra gjatë studimeve në punën aktuale sipas viteve të diplomimit


	2020	2021	2022	2023	2024
Aspak/pak	47.3%	43.7%	33.6%	32.2%	40.1%
Mesatar	6.5%	10.4%	14.1%	9.0%	10.8%
Shumë/jashtëzakonisht shumë	46.2%	46.0%	52.3%	58.7%	49.1%

Për të diplomuarit e punësuar në të gjitha rajonet vihet re se më shumë se gjysma i përdorin njohuritë e fituara gjatë studimeve shumë/jashtëzakonisht shumë në punën aktuale.



5 Grafiku përfshin vetëm ky kategori të punësimit: të punësuarit dhe ata që punojnë dhe studiojnë.

Graf. 9 Përdorimi i njohurive sipas rajoneve, 2024



Të diplomuarit të cilët kanë studiuar në Hoteleri-Turizëm, kanë përqindjen më të lartë të të rinjve që i përdorin shumë/ jashtëzakonisht shumë njohuritë e fituara gjatë studimeve në punën aktuale, 70,2% ndjekur nga drejtimi i ShMT, 62.3%.

Tabela 20. Lidhja e punës dhe studimet, si dhe aplikimi i njohurive të marra në shkollë në punë, 2024


	Në ç'skallë i përdor njohuritë që ke fituar gjatë studimeve në punë?
	Vetëm përngjigjet shumë/ jashtëzakonisht shumë
Bujqësi	4.5%
Detari	0.0%
Ekonomi -Biznes	32.2%
Elektroteknikë	48.3%
Gjeodezi	66.7%
Gjelogji	0.0%
Hoteleri-Turizëm	70.2%
Inxhinieri informatike Softwaresh	63.6%
Kërkim, shpim, shfrytëzim, nafte, gazi dhe uji	0.0%
Mekanike	46.9%
Ndërtim	71.4%
Përpunim druri	60.0%
Pyje	0.0%
Rrjete të dhënash (PILOT-GIZ)	16.7%
Shërbime Kujdesi për të moshuar (PILOT - GIZ)	0.0%
Shërbime mjeteshe transporti	62.3%
Shërbime sociale dhe shëndetësore	44.4%

	Në ç'skallë i përdor njohuritë që ke fituar gjatë studimeve në punë?
Teknologji Informacioni dhe Komunikimi	31.9%
Teknologji Ushqimore	20.0%
Tekstil Konfeksione	33.3%
Termohidraulike	50.0%
Veterinari	37.5%
Total	49.1%

5.5 Të diplomuarit e vetëpunësuar

Në vitin 2024, 6% e të diplomuarve rezultojnë të vetëpunësuar, një nivel pak më i ulët krahasuar me vitet e mëparshme (6.7% në 2022 dhe 6.9% në 2023). Ky tregues tregon se pjesa e të diplomuarve që zgjedhin rrugën e vetëpunësimit edhe pse në nivele të ulta mbetet relativisht i qëndrueshëm.

Graf. 10 Të vetëpunësuarit sipas viteve të studimit



Për të diplomuarit në vitin 2024, 69.1% e të vetëpunësuarve raportuan se biznesi është i familjes. Ky tregues paraqet një rënie krahasuar me 83.9% në 2023. Bizneset e hapura para diplomimit shfaqin një rritje për të diplomuarit në vitin 2024 (20.6%) krahasuar me vitin 2023 (2.3%), duke treguar një trend të rritjes së iniciativës së hershme për sipërmarrje të vetë të rinjve të diplomuar. Hapjet e biznesit pas diplomimit mbeten të kufizuara në të gjitha vitet, me përqindje relativisht të ulëta: 1.5% brenda një muaji dhe 5.9% brenda 9-12 muajve për të diplomuarit në vitin 2024. Ndërsa bizneset familjare mbeten mbizotëruese, vërehet një rritje e sipërmarrjes para diplomimit.


Tabela 21. Koha pas diplomimit për hapjen e biznesit sipas viteve

	2021	2022	2023	2024
Është biznesi i familjes	59.8%	65.9%	83.9%	69.1%
E kam hapur para diplomimit	13.7%	14.6%	2.3%	20.6%
1 muaj pas diplomimit	5.9%	6.1%	2.3%	1.5%
1 -3 muaj pas diplomimit	5.9%	1.2%	3.4%	0.0%

	2021	2022	2023	2024
3 - 6 muaj pas diplomimit	7.8%	4.9%	2.3%	2.9%
6 - 9 muaj pas diplomimit	2.0%	1.2%	0.0%	0.0%
9 - 12 muaj pas diplomimit	4.9%	6.1%	5.7%	5.9%

Përqindja e bizneseve të hapura nga të diplomuarit, të cilat nuk kanë punonjës të tjerë, është rritur nga 12.8% në vitin 2023 në 20.6% në vitin 2024. Bizneset me 1-3 punonjës kanë shënuar një ulje nga 52.3% në 42.6%, ndërsa ato me më shumë se 3 punonjës janë rritur lehtë, nga 34.9% në 36.8%. Të dhënat korrespondojnë me kohën e hapjes së biznesit, duke reflektuar një rritje të bizneseve të hapura para diplomimit, ku zhvillimi i kapaciteteve me burime njerëzore për bizneset e hapura para diplomimit kërkon kohë dhe përvojë.

Graf. 11 Numri i të punësuar në biznes, 2023 dhe 2024



Perspektiva e të vetëpunësuarve për vazhdimësinë e aktivitetit sipërmarrës tregon një tendencë të qartë drejt qëndrueshmërisë. Në vitin 2024, 87.1% e të vetëpunësuarve e shohin vetëpunësimin si një aktivitet të përhershëm, duke shënuar rritje krahasuar me 85.2% në 2023 dhe nivelet më të ulëta në vitet 2021 (59.8%) dhe 2022 (51.9%). Përqindja e atyre që e konsiderojnë vetëpunësimin si një aktivitet të përkohshëm deri në sigurimin e një punësimi më të sigurt ka rënë në 8.1% në vitin 2024, nga 12.5% në 2023 dhe 32.4% në 2021. Pjesa e të vetëpunësuarve që nuk e dinë ose kanë perspektiva të tjera mbetet e ulët (rreth 4.8%). Ky trend tregon një konsolidim të vetëpunësimit si opsion afatgjatë për të diplomuarit.


Tabela 22. Perspektiva e vetë-punësimit sipas viteve të diplomimit

	2021	2022	2023	2024
E shoh si një aktivitet të përhershëm timin	59.8%	51.9%	85.2%	87.1%
E shoh si një aktivitet të përkohshëm deri në një punësim më të sigurt në një kompani	32.4%	39.5%	12.5%	8.1%
Nuk e di	4.9%	8.6%	2.3%	4.8%
Tjetër	2.9%	0.0%	0.0%	0.0%

6. TË DIPLOMUARIT QË PO VAZHDOJNË KUALIFIKIME TË MËTEJSHME

Për të diplomuarit në vitin 2024, përqindja e atyre që kanë zgjedhur të vazhdojnë studime ose kualifikime të mëtejshme pas diplomimit arriti në 18.7%, duke shënuar një rritje krahasuar me vitin 2023 (15.5%).


Graf. 12 Përqindja e të diplomuarve që vazhdojnë studimet/kualifikimet e mëtejshme sipas viteve të diplomimit



Shumica e të diplomuarve që vijojnë studime apo trajnime janë të regjistruar në universitet (93.4%). Ndërkohë, qendrat e formimit profesional përfaqësojnë një pjesë më të vogël të ndjekësve (3.8%), me një rënie krahasuar me vitin 2023 (7.0%).


Analiza gjinore tregon se ka një tendencë më të lartë të djemve për të vazhduar trajnime në qendrat e formimit profesional në krahasim me vajzat.

Graf. 13 Institucion ku studion apo po trajnohesh sipas viteve të diplomimit



Studimi për të diplomuarit në vitin 2024 tregon se rreth 66.2% e të diplomuarve që vazhdojnë studimet po ndjekin studime që lidhen me shkollimin e tyre të mëparshëm, ndërsa 33.8% kanë zgjedhur një drejtim tjetër. Kjo përfaqëson një rritje krahasuar me vitin 2023, kur vetëm 59.6% vijonin në të njëjtën fushë, por mbetet më e ulët se nivelet e viteve 2021–2022 (rreth 74–76%).

Graf. 14 Lidhja e fushës së studimeve me studimet e mëparshme sipas viteve të diplomimit



Përqindjet më të larta të lidhjes së studimeve të mëparshme me studimet aktuale shënohen tek drejtimit Gjeodezi dhe Veterinari (100%), si dhe tek Inxhinieri Informatike Softwaresh (93.3%) dhe Teknologji Informatiçi dhe Komunikimi (80.6%). Një përqindje të moderuar të lidhjes shfaqin drejtimit Ekonomi-Biznes (73.0%), Shërbime Sociale dhe Shëndetësore (76.5%) dhe Elektroteknikë (70.8%), duke reflektuar një orientim relativisht të qëndrueshëm drejt specializimeve të mëtejshme. Ndërsa fusha si Bujqësi (33.3%), Hoteleri-Turizëm (20.0%) dhe Termohidraulike (44.4%) paraqesin përqindje të ulëta.

Mund të themi se drejtimet teknike dhe të lidhura me teknologjinë kanë përputhshmëri më të lartë të studimeve të mëparshme me dëshirën për të vazhduar të njëjtat studime dhe më tej.

Tabela 23. Lidhja e fushës së studimeve me studimet e mëparshme sipas drejtimit 2024

Drejtimi	Përqindja e të diplomuarve të cilët po ndjekin studime që kanë lidhje me studimet e mëparshme
Bujqësi	33.3%
Ekonomi- Biznes	73.0%
Elektroteknikë	70.8%
Gjeodezi	100.0%
Hoteleri-Turizëm	20.0%
Inxhinieri Informatike Softwaresh	93.3%
Mekanike	50.0%

Drejtimi	Përqindja e të diplomuarve të cilët po ndjekin studime që kanë lidhje me studimet e mëparshme
Ndërtim	0%
Përpunim druri	0%
Rrjete të dhënash (PILOT GIZ)	71.4%
Shërbim mjetesësh Transporti	56.0%
Shërbime Sociale dhe Shëndetësore	76.5%
Teknologji Informacioni dhe Komunikimi	80.6%
Teknologji Ushqimore	50.0%
Tekstil -Konfeksione	0%
Termohidraulike	44.4%
Veterinari	100.0%

Në vitin 2024, arsyeja kryesore pse të diplomuarit nga arsimit profesional po ndjekin studime të mëtejshme është të fitojnë një kualifikim më të lartë (62.1%), duke u rritur ndjeshëm krahasuar me tre vitet e mëparshme dhe duke shënuar nivelin më të lartë të periudhës së analizuar.

Ndërkohë, arsyeja e dytë më e rëndësishme ka qenë ndjekja e një karriere tjetër profesionale (21.8%), me një stabilitet gjatë viteve 2021-2024. Nga ana tjetër, përqindja e atyre që i shohin studimet si mënyrë për të rritur mundësitë për një punë më të mirë ka rënë ndjeshëm në vitin 2024 (15.0%) pas një kulmi në vitin 2023 (23.8%), duke treguar se motivimi kryesor i të diplomuarve për të vazhduar studimet nuk lidhet me mungesën e punës, por me dëshirën për avancim dhe specializim profesional.

Tabela 24. Arsyeja kryesore pse po ndjek këto studime/trajnim sipas viteve të diplomimit

	2021	2022	2023	2024
Për të fituar një kualifikim më të lartë	60.1%	56.7%	54.3%	62.1%
Për të rritur mundësitë për të gjetur një punë më të mirë	16.6%	22.3%	23.8%	15.0%
Për të ndjekur një karrierë tjetër profesionale	21.8%	19.5%	20.9%	21.8%
Nuk po gjeja dot punë	1.6%	1.1%		0.5%
Tjetër	0%	0.4%	1.0%	0.5%


7. TË DIPLOMUARIT TË CILËT NUK PUNOJNË

Në këtë seksion do të analizohen të gjithë të diplomuarit në arsimin profesional të cilët nuk punojnë. Kjo kategori përfshin: a) ata të cilët nuk punojnë, por kërkojnë një punë, b) ata që nuk punojnë dhe nuk kërkojnë një punë, si dhe c) kategoria e të diplomuarve që nuk punojnë për arsye të tjera (si p.sh. përmbushin detyra shtëpiake, apo arsye tjetër).

7.1 Të kërkuarit për punë


Pjesëmarrja aktive e të diplomuarve në kërkimin e punës ka shënuar luhatje të dukshme gjatë viteve 2021-2024. Nga 24.8% në vitin 2021, përqindja u rrit në 58.1% në vitin 2023, duke treguar një angazhim më aktiv të të rinjve në tregun e punës. Megjithatë, në vitin 2024 ky tregues ra në nivelin 33.7%.

Graf. 15 Shkalla e papunësisë 2021-2024




Nëse i referohemi shkallës së papunësisë (të papunëve aktiv) ajo në vitin 2024 shënoi vlerën më të ulët ndër këto vite, vetëm 6.1%, një rënie e ndjeshme krahasimisht me vitin 2020 ku shënohej vlera 22.8%.

Graf. 16 Kërkimi i një punë 4 javët e fundit sipas viteve të diplomimit




Në vitin 2024, përqindja e të diplomuarve që kanë kërkuar punë gjatë 4 javëve në Rajonin Verior shfaq nivelin më të lartë të angazhimit (45.7%), ndërsa Rajoni Qendror qëndron në një nivel mesatar (36.2%). Nga ana tjetër, Rajoni Jugperëndimor (28.1%) dhe Rajoni Juglindor (26.0%) shfaqin nivele më të ulëta të kërkimit aktiv të punës.

Graf. 17 Kërkimi i një punë 4 javët e fundit sipas rajoneve, 2024



Pjesëmarrja e të diplomuarve të papunë (në momentin e anketimit) në tregun e punës pas përfundimit të shkollës ka mbetur e kufizuar gjatë viteve 2021–2023 (rreth 46–47%). Në vitin 2024 vihet re një përmirësim i lehtë, ku 50% e të diplomuarve kanë qenë të punësuar të paktën një herë përpara momentit të anketimit.

Graf. 18 A ke qenë ndonjëherë i punësuar që nga mbarimi i shkollës sipas viteve të diplomimit



Të dhënat tregojnë ndryshime të dukshme në mënyrat e kërkimit të punës nga të diplomuarit gjatë katër viteve të fundit. Në vitin 2021, mbështetja kryesore ka qenë te rrjetet familjare e miqësore (80%) dhe lajmërimeve të publikuara në internet, rrjete sociale (68.3%). Në vitet në vijim, përdorimi i këtyre metodave ka rënë ndjeshëm, ndërkohë që në vitin 2024 vihet re një rritje e përdorimit të Zyrave të Punës (17.3%), duke treguar një orientim më të madh drejt kanaleve institucionale. Megjithatë, mënyrat informale (përmes lidhjeve personale) vijojnë ende të kenë përqindje të larta përdorimi (41.8%) edhe pse një shifër e përgjysmuar në krahasim me vitin 2021(80%).

Tabela 25. Mënyra e kërkimit të punës (ata që kanë kërkuar punë 4 javët e fundit) sipas viteve të diplomimit

	2021	2022	2023	2024
Nëpërmjet Zyrës së Punës	10.0%	12.0%	4.2%	17.3%
Nëpërmjet lajmërimeve të publikuara në faqe interneti, media sociale etj.	68.3%	54.7%	34.5%	29.6%
Nëpërmjet njohjeve, lidhjeve familjare, miqve, të njohurve	80.0%	44.0%	45.1%	41.8%
Duke kontaktuar drejtpërdrejtë me punëdhënësin tim (duke dërguar CV etj.)	5.0%	12.0%	15.5%	9.2%
Tjetër		1.3%	0.7%	2.0%

Mënyrat e kërkimit të punës ndryshojnë dukshëm sipas rajoneve. Rajoni Verior ka përdorim më të lartë të Zyrës së Punës (31.8%). Rrjetet personale (familjare, miq) mbeten metoda kryesore për gjetjen e punës, veçanërisht në Jugperëndim (61.5%) dhe Juglindje (43.5%).

Kontaktet direkte me punëdhënësin përdoren më shumë në Qendër dhe Juglindje, por mbeten të dytësore krahasuar me rrjetet personale. Të dhënat reflektojnë ende varësinë e të rinjve nga lidhjet personale në disa rajone, ndërsa në Veri dhe Qendër ka një orientim më të madh drejt institucioneve dhe kanaleve formale.

Tabela 26. Mënyra e kërkimit të punës sipas rajoneve, 2024

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Jugperëndimor	Rajoni Juglindor
Nëpërmjet Zyrës së Punës	31.8%	15.0%	0.0%	17.4%
Nëpërmjet lajmërimeve të publikuara në faqe interneti, media sociale etj.	27.3%	35.0%	30.8%	21.7%
Nëpërmjet njohjeve, lidhjeve familjare, miqve, të njohurve	36.4%	37.5%	61.5%	43.5%
Duke kontaktuar drejtpërdrejtë me punëdhënësin tim (duke dërguar CV etj.)	0.0%	12.5%	7.7%	13.0%
Tjetër	4.5%	0.0%	0.0%	4.3%

Nga të diplomuarit që nuk kanë kërkuar punë, arsyeja kryesore gjatë viteve 2021-2024 ka qenë ndryshimi i motivimit dhe preferencave personale. Ndërsa në vitin 2021 dhe 2022 një pjesë e madhe planifikonte largimin nga vendi (47% dhe 37.8%), kjo arsye bie ndjeshëm në 2024 (24.6%).

Në të kundërt, te të papunët mosdëshira për të punuar aktivisht rritet nga 17.1% në 2021 në 35.1% në 2024, duke u bërë arsyeja kryesore e mos kërkimit të punës. Arsye të tjera si detyrimet familjare dhe pritja për sezonin e përshtatshëm kanë ndikim të


moderuar, ndërsa sëmundja, paaftësia dhe mosbesimi se mund të gjesh punë mbeten shumë të ulëta.

Tabela 27. Arsyet e mos kërkimit të një pune (ata që nuk kanë kërkuar punë) sipas viteve të diplomimit

	2021	2022	2023	2024
Nga sëmundja ose paaftësia	3.3%	2.8%	1.5%	0.9%
Kujdesem për fëmijët/familjen	4.4%	2.8%	15.2%	8.8%
Po pres të filloj punë së shpejti	11.0%	7.0%	10.6%	6.1%
Po pres për sezonin e përshtatshëm	3.3%	14.0%	16.7%	6.1%
Nuk kam dëshirë të punoj për momentin	17.1%	25.2%	31.8%	35.1%
Kam në plan të langohem nga vendi	47.0%	37.8%	19.7%	24.6%
Nuk kam besim se do të gjej një punë	2.8%	4.2%	0.0%	3.5%
Tjetër	11.0%	6.3%	4.5%	14.9%

Një analizë më e detajuar gjinore tregon se për të dy gjinitë arsyeja e mos kërkimit të një pune lidhet me mosdëshirën për të punuar. Nga ana tjetër vihet re se vajzat e përmendin më shpesh kujdesin për fëmijët/familjen (29.6%) si shkak për të mos kërkuar punë, ndërsa djemtë më shumë planin për t'u larguar nga vendi (29.9%). Shkak si mosbesimi për të gjetur punë është i rrallë dhe kryesisht tek djemtë, ndërsa arsye të tjera (të pa përfshira në listë) janë të ngjashme për të dyja gjinitë (~15%).

Graf. 19 Arsyet e mos kërkimit të një pune (ata që nuk kanë kërkuar punë) sipas gjinisë, 2024



7.2 Marrëdhënia me zyrat e punës


Përdorimi i shërbimeve të zyrës së punës nga të diplomuarit mbetet i ulët dhe jo i qëndrueshëm gjatë viteve 2021-2024. Të dhënat tregojnë se kjo mundësi për integrimin e tyre në tregun e punës vijon ende të mos shfrytëzohet mjaftueshëm nga të diplomuarit e papunë të arsimit profesional.

Tabela 28. Regjistruar si punëkërkuës i papunë tek zyra e punës sipas viteve të diplomimit

	2021	2022	2023	2024
Po	11.1%	16.3%	4.5%	14.6%
Jo	88.9%	83.7%	95.5%	85.4%

Përdorimi i Zyrave të Punës paraqet ndryshime sipas rajoneve. Rajoni Verior ka nivelin më të lartë të regjistrimit në zyrat e punës (30.8%), ndërsa Rajoni Jugperëndimor ka një përdorim minimal (3.2%). Rajoni Qendror dhe Juglindor qëndrojnë në nivele mesatare (12–15%).

Graf. 20 Regjistruar si punëkërkuës i papunë tek zyra e punës sipas rajoneve, 2024



Ansyeja kryesore e mosregjistrimit të të diplomuarve në zyrat e punës mbetet mungesa e interesit (78% në 2024). Ansye të tjera si mungesa e njohurive për regjistrim dhe mosbesimi tek shërbimet e zyrës së punës shfaqen si problem i përkohshëm, duke arritur kulmin në 2023 dhe duke u përminësuar dukshëm në 2024.

Tabela 29. Ansyet e mos regjistrimit në zyrat e punës sipas viteve të diplomimit

	2021	2022	2023	2024
Nuk di si të regjistrohem	2.4%	14.0%	26.4%	5.5%
Nuk besoj se do të më ndihmoj	9.0%	14.0%	30.6%	6.3%
Nuk kam interes të regjistrohem	88.6%	66.7%	42.1%	78.0%
Tjetër	0.0%	5.3%	0.8%	10.2%

Analiza rajonale tregon se arsyeja kryesore e mos regjistrimit në zyrat e punës mbetet mungesa e interesit në të gjitha rajonet (73–83%). Arsye të tjera si mosbesimi tek shërbimet shfaqen kryesisht në Veri dhe Jugperëndim, ndërsa mungesa e njohurive për regjistrim ka ndikim minimal.


Tabela 30. Arsyet e mos regjistrimit në zyrat e punës sipas rajoneve, 2024

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Jugperëndimor	Rajoni Juglindor
Nuk di si të regjistrohem	0.0%	4.3%	7.1%	7.5%
Nuk besoj se do të më ndihmoj	15.4%	6.5%	10.7%	0.0%
Nuk kam interes të regjistrohem	76.9%	73.9%	78.6%	82.5%
Tjetër	7.7%	15.2%	3.6%	10.0%

8. VLERËSIMI RETROSPEKTIV I TË DIPLOMUARVE

Të diplomuarit në arsimin profesional u pyetën nëse do të zgjidhnin sërish të njëjtin drejtim apo shkollë. Të dhënat tregojnë një trend pozitiv të kënaqësisë së të diplomuarve nga viti 2021 deri në vitin 2023, si në raport me shkollën ashtu edhe me drejtimin e studimit, duke patur parasysh që përqindjet pozitive për të rizgjedhur shkollën dhe drejtimin janë në trend rritës. Për të diplomuarit në vitin 2024 vihet re një rënie e lehtë e këtyre treguesve në krahasim me një vit më parë.

Graf. 21 Zgjedhja e të njëjtës shkollë dhe drejtim sipas viteve të diplomimit (Përgjigjet po)



Rezultatet sipas drejtimeve tregojnë nivele të larta kënaqësie të të diplomuarve me shkollën dhe drejtimin profesional të ndjekur, veçanërisht në drejtime si Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, ku 100% e të diplomuarve do ta përsërisnin zgjedhjen e tyre. Nga ana tjetër, drejtime si Tekstil-Konfeksione, Bujqësi, Teknologji Ushqimore dhe Kërkim/shfrytëzim i burimeve natyrore paraqesin shkallë më të ulët kënaqësie, veçanërisht për drejtimin.

Tabela 31. Zgjedhja e të njëjtës shkollë dhe të njëjtit drejtim

	Nëse do të kishe mundësi të zgjidhje përsëri, a do të zgjidhje të njëjtën degë/drejtim?	Nëse do të kishe mundësi të zgjidhje përsëri, a do të zgjidhje të njëjtën shkollë?
	Përgjigjet po	Përgjigjet po
Bujqësi	53%	75%
Detari	50%	75%

	Nëse do të kishe mundësi të zgjidhje përsëri, a do të zgjidhje të njëjtën degë/drejtim?	Nëse do të kishe mundësi të zgjidhje përsëri, a do të zgjidhje të njëjtën shkollë?
Ekonomi- Biznes	80%	88%
Elektroteknikë	83%	88%
Gjeodezi	80%	80%
Gjeologji	80%	100%
Hoteleri-Truizëm	87%	92%
Inxhinieri Informatike Softwaresh	97%	100%
Kërkim, shpim, shfrytëzim, nafte, gazi dhe uji	50%	50%
Mekanike	76%	86%
Ndërtim	82%	82%
Përpunim druri	100%	100%
Pyje	100%	100%
Rrjete te dhënash (PILOT GIZ)	67%	67%
Shërbim mjetesh Transporti	85%	90%
Shërbime kujdesi për te moshuar (PILOT GIZ)	100%	100%
Shërbime Sociale dhe Shëndetësore	73%	89%
Teknologji Informacioni dhe Komunikimi	81%	84%
Teknologji Ushqimore	53%	81%
Tekstil -Konfeksione	29%	71%
Termohidraulike	88%	88%
Veterinari	78%	91%

Duke analizuar aspekte më konkrete të përvojës në shkollë, rezultatet tregojnë se vlerësimet kanë pasur një rritje të vazhdueshme nga viti 2021 deri në vitin 2023, duke arritur nivelet më të larta gjatë këtij viti. Për të diplomuarit në vitin 2024 vihet re një ulje e lehtë e përgjithshme e vlerësimit të këtyre treguesve, sidomos në metodat e mësimdhënies, aftësitë e stafit, si dhe në praktikën në biznes. Ndërkohë, këshillimi i karrierës dhe bashkëpunimi me zyrat e punës mbeten aspektet më pak të vlerësuara në të gjitha vitet.

Tabela 32. Aspektet e shkollës që janë vlerësuar sipas viteve (përqindja e të diplomuarve që i ka vlerësuar shumë/ose jashtëzakonisht shumë)

	2021	2022	2023	2024
Infrastruktura (psh. klasat, laboratorët etj.)	77.6%	82.5%	86.9%	80.3%
Kurrikulat	81.5%	72.8%	87.3%	78.9%
Tekset dhe materialet për të mësuar	85.8%	74.0%	87.6%	79.9%
Metodat/mënyrat e mësimdhënies	90.5%	83.7%	88.0%	81.5%
Aftësitë teorike dhe praktike të stafit mësimdhënës	93.4%	86.4%	88.5%	83.1%
Praktika në shkollë	87.8%	79.4%	88.4%	78.9%
Praktika në biznes	87.9%	76.9%	87.6%	79.7%
Këshillimi i karrierës	69.6%	67.8%	86.6%	68.0%
Bashkëpunimi i shkollës me bizneset	74.3%	69.3%	86.0%	75.6%
Bashkëpunimi i shkollës me zyrat e punës	58.4%	60.9%	85.4%	72.7%

Analiza rajonale tregon se Rajoni Qendror dhe ai Jugperëndimor shfaqin rezultate më pozitive, me mbi 80% vlerësime shumë ose jashtëzakonisht pozitive për shumicën e aspekteve, sidomos në lidhje me aftësitë e stafit, metodat e mësimdhënies dhe praktikatat. Ndërkohë, Rajoni Verior dhe Juglindor shfaqin nivele më të ulëta kënaqësie (60–74%), sidomos në këshillimin e karrierës dhe mundësitë për praktika profesionale. Në të gjitha rajonet, bashkëpunimi i shkollave me zyrat e punës dhe ofrimi i këshillimit të karrierës mbeten fushat me vlerësim më të ulët në krahasim me elementët e tjerë të vlerësimit.

Tabela 33. Aspektet e shkollës që janë vlerësuar sipas rajoneve (përqindja e të diplomuarve që i ka vlerësuar shumë/ose jashtëzakonisht shumë), 2024

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Jug perëndimor	Rajoni Juglindor
Infrastruktura (p.sh. klasat, laboratorët etj.)	73.8%	83.8%	80.8%	74.5%
Kurrikulat	69.2%	83.6%	80.9%	70.5%
Tekset dhe materialet për të mësuar	72.7%	83.6%	86.0%	69.3%
Metodat/mënyrat e mësimdhënies	70.0%	84.8%	88.2%	74.6%
Aftësitë teorike dhe praktike të stafit mësimdhënës	71.9%	85.5%	90.8%	77.3%
Praktika në shkollë	68.0%	82.0%	86.2%	71.7%
Praktika në biznes	70.5%	83.0%	86.1%	71.3%
Këshillimi i karrierës	62.8%	71.0%	71.5%	60.2%
Bashkëpunimi i shkollës me bizneset	70.3%	79.0%	76.2%	69.1%
Bashkëpunimi i shkollës me zyrat e punës	63.8%	77.9%	71.1%	65.6%

8.1 Pritshmëritë për të ardhmen

Pritshmëritë e të diplomuarve për 2 vitet e ardhshme paraqesin luhatje në disa aspekte. Një në tre të diplomuar ka pritshmëri që lidhen me punësimin në biznesin e tyre (31.8%). Megjithatë në krahasim me një vit më parë vihet re se ndërkohë që vitin 2023 dominonte pritshmëria për t'u punësuar me një pagë të kënaqshme (39%), në vitin 2024 kjo bie ndjeshëm (17.4%), duke u shoqëruar edhe me uljen e pritshmërive për t'u punësuar në një punë që lidhet me fushën e studimit (14.5%).

Nga ana tjetër, është rritur ndjeshëm orientimi drejt sipërmarrjes (31.8%) dhe dëshira për studimeve të mëtejshme (21.7%). Ndërkohë, dëshira për emigrim mbetet e pranishme (12.1%), edhe pse më e ulët se në vitet e para të vëzhgimit.

Analiza gjinore tregon se më shumë djem se vajza dëshirojnë të jenë duke punuar në biznesin e tyre, përkatësisht 33.9% për djemtë dhe 22.5% për vajzat. Ndërkohë te vajzat vihet re një dëshirë më e madhe se te djemtë për të vazhduar studimet e mëtejshme, 31.1% në krahasim me 19.6% për djemtë.

Tabela 34. Pritshmëritë për 2 vitet e ardhshme sipas viteve të diplomimit

	2021	2022	2023	2024
Të jem i/e punësuar me një pagë të kënaqshme	13.2%	8.00%	39.0%	17.4%
Të jem i/e punësuar në një punë që të lidhet me fushën time të studimit	16.6%	31.40%	26.0%	14.5%
Të jem duke punuar në biznesin tim	24.8%	23.20%	23.4%	31.8%
Të jem duke ndjekur studime të mëtejshme	10.1%	21.30%	5.0%	21.7%
Të kem emigruar jashtë vendit	23.1%	12.50%	6.4%	12.1%
Të kem migruar në një qytet tjetër brenda vendit	0.4%	0.60%	0.3%	0.6%
Tjetër	11.8%	3.00%	0.1%	2.0%

Analiza rajonale për pritshmëritë e të diplomuarve tregon se punësimi me një pagë të kënaqshme është në nivel më të lartë për të diplomuarit në rajonin e Veriut (23.2%) dhe më pak në Juglindje (11.6%). Megjithatë, niveli i pritshmërive për punësim në fushën e studimit mbetet i ulët në të gjitha rajonet (10-16%). Sipërmarrja del si alternativa më e përmendur nga të rinjtë, me mbi 30% në të gjitha rajonet dhe më e lartë në Jugperëndim (35.9%). Interesi për studime të mëtejshme është më i lartë në Qendër dhe Jugperëndim (rreth 22-23%), ndërsa dëshira për emigrim jashtë vendit mbetet e pranishme në nivele të moderuara (10-15%). Migrimi brenda vendit është pothuajse i papërfillshëm

Tabela 35. Pritshmëritë për 2 vitet e ardhshme sipas rajoneve, 2024

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Jug perëndimor	Rajoni Juglindor
Të jem i/e punësuar me një pagë të kënaqshme	23.2%	18.4%	15.6%	11.6%
Të jem i/e punësuar në një punë që të lidhet me fushën time të studimit	14.7%	16.0%	10.5%	13.1%

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Jug perëndimor	Rajoni Juglindor
Të jem duke punuar në biznesin tim	31.1%	30.5%	35.9%	32.8%
Të jem duke ndjekur studime të mëtejshme	14.2%	23.1%	22.4%	22.0%
Të kem emigruar jashtë vendit	14.2%	10.0%	13.9%	15.4%
Të kem migruar në një qytet tjetër brenda vendit	0.0%	0.0%	0.4%	3.1%
Tjetër	2.6%	2.0%	1.3%	1.9%



9. KONKLUZIONE

Studimi kombëtar i gjurmimit të të diplomuarve në ansimin profesional në vitin 2024 përfshiu 1,143 të anketuar nga një total prej 2,851 të diplomuar, duke siguruar një pjesëmarrje prej 40.1%. **Karakteristikat demografike të kampionit** (gjinia, rajoni dhe drejtimi profesional) **përputhen me ato të popullatës së përgjithshme**, duke e bërë studimin përfaqësues për të gjithë të diplomuarit në ansimin profesional gjatë vitit 2024.

Rezultatet tregojnë se **62.8% e të diplomuarve janë të punësuar, 18.7% vazhdojnë studimet dhe 18.5% janë të papunë në kërkim të një pune ose inaktivë.**

Rezultatet në krahasim me një vit më parë tregojnë një rënie të lehtë shkallës së të punësuarve shoqëruar gjithashtu nga rënie të shkallës së papunësisë, ku përkatesisht në vitin 2024 62.8% të të diplomuarve janë punësuar dhe 6.1% janë të papunë. Kjo shpjegohet nga një **rritje e interesit për vijimin e studimeve pas diplomimit** (18.7% në 2024 kundrejt 15.5 në 2023). Sipas gjinisë, djemtë kanë një shkallë punësimi më të lartë se vajzat (65.8% kundrejt 47.9%), trend i ngjashëm me vitet e mëparshme.

Nëse i referohemi të dhënave të nivelit të punësueshmërisë në seri kohore, nga viti 2020 (40%) dhe në vijim kemi pasur një trend domethënës rritës të nivelit të punësueshmërisë, me vitin 2023 që ka shfaqur dhe nivelin më të lartë 67.6%. Viti 2024 ka pësuar një ulje të lehtë që shpjegohet me rritjen e përqindjes së të diplomuarve që kanë zgjedhur të vijnë studimet e mëtejshme.

Analiza sipas drejtimeve duke u fokusuar tek drejtimet me pjesëmarrje më të lartë të të diplomuarve, tregon se **norma më e lartë e punësimit është në Hoteleri-Turizëm** (78.5%). Në disa drejtime si Ekonomi-Biznes, TIK, Inxhinieri Softwarësh dhe Elektroteknikë vihet re prirja për të ndjekur studime të mëtejshme, çka ul përkohësisht nivelin e punësimit. **Në total, 81.5% e të diplomuarve janë të punësuar ose në studime të mëtejshme.**

Rrjetet personale mbeten kanali kryesor i punësimit (62.7% në 2024), ndërkohë që përdorimi i platformave online dhe mediave sociale ka rënë në krahasim me një vit më parë (nga 20.5% në 2023 në 11.5% në 2024). Ky trend është i dukshëm në të gjitha rajonet, me nivele më të larta në Jugperëndim (66.7%).

Sa i përket të ardhurave, **vihet re një zhvendosje drejt pagave më të larta gjatë gjithë periudhës së studimit 2020-2024.** Përqindja e të diplomuarve me të ardhura deri në 40,000 lek ka rënë ndjeshëm (nga 39.8% në 2021 në 8.6% në 2024), ndërsa ata me të ardhura 60,000-95,000 lek janë rritur nga 6.4% në 2021 në 35.8% në 2024.

Siguria në punë ka shënuar përmirësim: përqindja e të diplomuarve që ndihen “shumë të sigurt” në vendin e punës është rritur nga 22.7% në 2023 në 41.7% në 2024.

Analiza e lidhjes së arsimit me punën aktuale tregon se, gjatë periudhës 2020–2024, një pjesë e konsiderueshme e të diplomuarve punojnë në fusha të lidhura me ansimin e tyre. Në vitin 2024, 54.5% e të diplomuarve të punësuar raportuan se puna e tyre është e lidhur me ansimin e ndjekur.

Rreth gjysma e të diplomuarve të punësuar po i përdorin shumë/ jashtëzakonisht shumë njohuritë e marra gjatë studimeve në punën aktuale, 49.1%. Analiza e përdorimit të njohurive sipas gjinisë tregon se më shumë djem se vajza kanë deklaruar se po i përdorin shumë ose jashtëzakonisht shumë njohuritë e fituara në shkollë në punën

aktuale, përkatësisht 50.4% për djemtë dhe 38.4% për vajzat. Relevanca e punës dhe studimet shfaq luhatje sipas drejtimeve. Duke u fokusuar tek drejtimit me më shumë të diplomuar mund të themi se ndër to **drejtimit e Elektroteknikës (53.1%), Hoteleri-Turizëm (78.4%), Shërbime mjetesh transporti (71.3%) kanë përpjesën më të lartë të të diplomuarve që po kryejnë një punë që lidhet me studimet e kryera** gjatë arsimit profesional. Ndër to të rinjtë të cilët kanë studiuar në Hoteleri-Turizëm, kanë përqindjen më të lartë të të rinjve që i përdorin shumë/jashtëzakonisht shumë njohuritë e fituara gjatë studimeve në punën aktuale.

Për të diplomuarit në vitin 2024, 6.0% e të diplomuarve rezultojnë të vetëpunësuar, një nivel pak më i ulët krahasuar me vitet e mëparshme (6.7% në 2022 dhe 6.9% në 2023). 69.1% e të vetëpunësuarve raportuan se biznesi është i familjes. Ky tregues paraqet një rënie krahasuar me 83.9% në 2023.

Bizneset e hapura para diplomimit shfaqin një rritje në vitin 2024 (20.6%) krahasuar me vitin 2023 (2.3%), duke treguar një trend të rritjes së iniciativës së hershme për sipërmarrje.

Perspektiva e të vetëpunësuarve për vazhdimësinë e aktivitetit sipërmarrës tregon një tendencë të qartë drejt qëndrueshmërisë. Në vitin 2024, 87.1% e të vetëpunësuarve e shohin vetëpunësimin si një aktivitet të përhershëm, duke shënuar rritje krahasuar me 85.2% në 2023.

Interesi për vazhdimin e studimeve pas diplomimit ka shënuar rritje, duke arritur në 18.7% në vitin 2024 kundrejt 15.5% në vitin 2023. Shumica e të diplomuarve që kanë zgjedhur të ndjekin studime të mëtejshme (62.1%) e kanë bërë këtë me synimin për të fituar një kualifikim më të lartë, çka tregon një orientim më të theksuar drejt avancimit dhe specializimit profesional.

Rreth 66.2% e të diplomuarve që vazhdojnë studimet deklarojnë se fushat e studimeve apo trajnimeve që po ndjekin lidhen me shkollën e tyre të mëparshme, ndërsa 33.8% kanë zgjedhur një drejtim tjetër. Kjo përfaqëson një rritje krahasuar me vitin 2023, kur vetëm 59.6% vijonin në të njëjtën fushë. Analiza sipas profileve të studimit tregon se drejtimit teknike dhe të lidhura me teknologjinë kanë përputhshmërinë më të lartë të studimeve të mëparshme më dëshirën për të vazhduar të njëjtat studime dhe më tej.

Për të diplomuarit në vitin 2024, treguesi i kërkimit aktiv të punës nga të diplomuarit e papunë ra në 33.7%. Megjithatë, vihet re një **rritje e ndjeshme e përdorimit të Zyrave të Punës për të kërkuar punë (17.3%), duke reflektuar një orientim më të madh drejt kanaleve institucionale të ndërmjetësimit.** Në nivel rajonal, Rajoni Verior shënon përqindjen më të lartë të përdorimit të Zyrës së Punës (31.8%). Pavarësisht kësaj, rrjetet personale (familjare dhe shoqërore) mbeten mënyra kryesore e kërkimit të punës, sidomos në Rajonin Jugperëndimor (61.5%) dhe Juglindor (43.5%). Gjithashtu, regjistrimi i të papunëve në zyrat e punës ka njohur rritje të ndjeshme në vitin 2024 (14.6%), krahasuar me vetëm 4.5% në vitin 2023

Vlerësimi i të diplomuarve për shkollën ka qenë pozitiv: 87.6% do të zgjidhnin të njëjtën shkollë dhe 80.0% të njëjtin drejtim studimi. Metodatat e mësimdhënies, kompetencat e stafit dhe infrastruktura janë vlerësuar shumë pozitivisht, ndërsa këshillimi i karrierës dhe bashkëpunimi me zyrat e punës mbeten fusha që kërkojnë përmirësim.

Sa i përket pritshmërive për të ardhmen, një në tre të diplomuar fokusohen tek punësimi (31.9%). Megjithatë, krahasuar me vitin 2023, **është rritur orientimi i të diplomuarve në arsimin profesional drejt sipërmarrjes (31.8%) dhe studimeve të mëtejshme (21.7%),** ndërsa dëshira për emigrim mbetet e pranishme, por në nivele më të ulëta (12.1%).

ANEKS

Tabela 36. Statusi i punësimit sipas shkollave, 2024

	Të punësuar	Studime te mëtejshme	Total të punësuar ose në studime	NEET	Total të anketuar ⁶	Total të diplomuar
Shkolla e mesme profesionale "Kristo Isak"	65.0%	15.0%	80.0%	20.0%	20	40
Shkolla Mekanike Bujqësore Lushnje	77.8%	4.4%	82.2%	17.8%	45	97
Shkolla Profesionale Bujqësore Kamëz	65.0%	22.5%	87.5%	12.5%	80	304
Shkolla e mesme profesionale "Mihal Shahini" Cërrik	33.3%	20.0%	53.3%	46.7%	15	24
Shkolla e mesme profesionale "Petro Sota"	46.9%	40.6%	87.5%	12.5%	32	134
Shkolla e mesme profesionale "Stiliano Bandilli"	88.2%	0.0%	88.2%	11.8%	17	37
Shkolla e mesme profesionale "Tregtare"	72.4%	3.4%	75.9%	24.1%	29	37
Shkolla e Mesme Bujqësore "Rakip Kryeziu"	16.7%	75.0%	91.7%	8.3%	12	26
Shkolla e Mesme Kombëtare Agrobiznesit Golem (Kavajë) "Charles Telford Erickson"	78.6%	21.4%	100.0%	0.0%	14	24
Shkolla e Mesme Profesionale "Kolin Gjoka"	78.6%	10.7%	89.3%	10.7%	28	74
Shkolla e Mesme Profesionale "Nazmi Rushiti"	25.0%	14.3%	39.3%	60.7%	28	48
Shkolla e mesme profesionale "Thoma Papapano"	50.0%	28.6%	78.6%	21.4%	14	20
Shkolla e Mesme Teknike Ekonomike Hoteleri-Turizëm "Antoni Athanas" Sarandë	57.1%	0.0%	57.1%	42.9%	14	24
Shkolla e Mesme Teknologjike "Hysen Çela"	77.5%	9.0%	86.5%	13.5%	89	187



6 Shënim: Interpretimi i shifrave të vogla duhet bënë me rezerva.

	Të punësuar	Studime te mëtejshme	Total të punësuar ose në studime	NEET	Total të anketuar ⁶	Total të diplomuar
Shkolla Havzi Nela Kukës	100.0%	0.0%	100.0%	0.0%	1	6
Shkolla Hoteleri -Turizëm	79.5%	10.3%	89.7%	10.3%	39	146
Shkolla industriale "Arben Broci"	79.4%	2.9%	82.4%	17.6%	34	88
Shkolla Industriale "Pavarësia"	71.7%	2.2%	73.9%	26.1%	46	97
Shkolla Ndërtimit "Karl Gega"	69.9%	19.2%	89.0%	11.0%	73	204
Shkolla e mesme profesionale "Beqir Çela"	77.2%	14.9%	92.1%	7.9%	101	238
Shkolla e mesme profesionale "Ndre Mjeda"	50.0%	16.7%	66.7%	33.3%	12	24
Shkolla Profesionale Elbasan	48.1%	24.7%	72.8%	27.2%	81	239
Shkolla e mesme profesionale Shërbimet Korçë	50.0%	20.8%	70.8%	29.2%	24	56
Shkolla e mesme profesionale Teknike Korçë	51.1%	15.6%	66.7%	33.3%	45	83
Shkolla Teknike Ekonomike	53.1%	35.8%	88.9%	11.1%	81	134
Shkolla Teknike Elektrike "Gjergji Canco"	50.0%	33.3%	83.3%	16.7%	78	207
Shkolla Teknike Pyjore "Kol Margjini"	25.0%	0.0%	25.0%	75.0%	8	11
Shkolla Tekniko-Profesionale "Enver Qiraxhi" Pogradec	75.0%	0.0%	75.0%	25.0%	12	45
Shkolla Teknologjike "Hamdi Bushati"	70.7%	9.8%	80.5%	19.5%	41	126
Shkolla e mesme profesionale "Hermann Gmeiner"	43.3%	50.0%	93.3%	6.7%	30	70
Totali	62.8%	18.7%	81.5%	18.5%	1,143	2,851

Tabela 37. Vlerësimi i elementëve të shkollës sipas drejtimeve, 2024 (% e të diplomuarve që i kanë vlerësuar shumë mirë ose jashtëzakonisht mirë)

	Infrastruktura	Kurrikulat	Tekstet dhe materialet për të mësuar	Metodat/ mënyrat e mësimit	Aftësitë teorike dhe praktike të stafit mësues
Bujqësi	68.8%	68.8%	68.8%	75.0%	78.1%
Detari	75.0%	75.0%	75.0%	75.0%	75.0%
Ekonomi- Biznes	86.1%	84.3%	83.3%	87.0%	88.7%
Elektroteknikë	81.7%	80.0%	82.2%	82.6%	82.6%
Gjeodezi	80.0%	80.0%	80.0%	80.0%	80.0%
Gjeologji	40.0%	60.0%	40.0%	40.0%	60.0%
Hoteleri-Turizëm	90.6%	88.1%	90.4%	92.4%	92.4%
Inxhinieri Informatike Softwarësh	86.7%	89.7%	86.7%	86.7%	86.7%
Kërkim, shpim, shfrytëzim, nafte, gazi dhe uji	100.0%				
Mekanike	68.6%	72.5%	76.5%	80.4%	78.4%
Ndërtim	72.7%	54.5%	54.5%	54.5%	54.5%
Përpunim druri	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
Pyje	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
Rrjete të dhënash (PILOT GIZ)	75.0%	81.3%	75.0%	81.3%	81.3%
Shërbim mjeteve Transporti	82.0%	80.2%	80.7%	82.0%	86.2%
Shërbime kujdesi për të moshuar (PILOT GIZ)	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
Shërbime Sociale dhe Shëndetësore	67.6%	67.6%	67.6%	67.6%	67.6%
Teknologji Informacioni dhe Komunikimi	71.4%	70.2%	71.8%	70.2%	74.0%
Teknologji Ushqimore	76.3%	73.7%	78.9%	71.1%	78.9%
Tekstil -Konfeksione	80.0%	66.7%	80.0%	86.7%	85.7%
Termohidraulike	70.4%	74.1%	72.2%	79.6%	79.6%
Veterinari	91.3%	82.6%	87.0%	87.0%	82.6%

	Praktika në shkollë	Praktika në biznes	Këshillimi i karrierës (p.sh. për të gjetur punë etj.)	Bashkëpunimi i shkollës me bizneset	Bashkëpunimi i shkollës me zyrat e punës
Bujqësi	75.0%	71.9%	56.3%	65.6%	65.6%
Detari	75.0%	75.0%	75.0%	75.0%	75.0%
Ekonomi- Biznes	81.7%	82.6%	56.5%	78.1%	73.9%
Elektroteknikë	72.7%	72.7%	69.1%	70.9%	69.7%
Gjeodezi	80.0%	80.0%	80.0%	80.0%	80.0%
Gjeologji	40.0%	40.0%	40.0%	40.0%	40.0%
Hoteleri-Turizëm	91.0%	92.4%	87.9%	90.4%	86.7%
Inxhinieri Informatike Softwanesh	85.7%	86.7%	86.7%	86.2%	86.7%
Kërkim, shpim, shfrytëzim, naftë, gaz dhe uji	50.0%	50.0%			
Mekanike	78.4%	82.4%	66.0%	76.5%	74.5%
Ndërtim	63.6%	63.6%	54.5%	54.5%	54.5%
Përpunim druri	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
Pyje	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
Rrjete të dhënash (PILOT GIZ)	75.0%	75.0%	75.0%	75.0%	75.0%
Shërbim mjetesh Transporti	83.1%	86.7%	68.1%	78.3%	75.3%
Shërbime kujdesi për të moshuar (PILOT GIZ)	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
Shërbime Sociale dhe Shëndetësore	64.9%	64.9%	56.8%	64.9%	64.9%
Teknologji Informacioni dhe Komunikimi	68.3%	65.7%	52.9%	59.6%	54.8%
Teknologji Ushqimore	78.9%	78.9%	68.4%	76.3%	68.4%
Tekstil -Konfeksione	60.0%	53.3%	40.0%	53.3%	46.7%
Termohidraulike	77.8%	75.9%	64.2%	71.7%	69.8%
Veterinari	77.3%	82.6%	87.0%	87.0%	82.6%

Tabela 38. Të ardhurat sipas kategorive të punësimit, 2024

	I/E punësuar	I/E vetë-punësuar	Punoj dhe studioj (ose trajnohem) në të njëjtën kohë	Total
Deri në 40.000 lekë	8.30%	6.30%	11.40%	8.60%
40.001-50.000 lekë	17.10%	15.60%	22.90%	18.00%
50.001-60.000 lekë	21.90%	14.10%	24.80%	21.50%
60.001-95.000 lekë	37.10%	32.80%	32.40%	35.80%
95.001-120.000 lekë	9.70%	14.10%	5.70%	9.50%
Mbi 120.000 lekë	5.90%	17.20%	2.90%	6.60%
Totali	100.00%	100%	100%	100%

Tabela 39. Relevanca sipas kategorive të punësimit, 2024

	A lidhet/është e ngjashme puna që bën me atë që ke studiuar?	
	Po	Jo
I/E punësuar	56.1%	43.9%
I/E vetë-punësuar	56.7%	43.3%
Punoj dhe studioj (ose trajnohem) në të njëjtën kohë	47.0%	53.0%
Totali	54.5%	45.5%



TË DIPLOMUARIT NGA
ARSIMI PROFESIONAL **2024**
GJURIMI NË NIVEL KOMBËTAR